

BAHRI BECI

KOMUNIKOJMË DHE HARTOJMË PËRDORIM GJUHËN

GJUHA SHQIPE 7
për klasën e shtatë të shkollës fillore nëntëvjeçare
LIBRI I MËSUESIT



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore
PODGORICË, 2007

Dr. Bahri Beci

KOMUNIKOJMË DHE HARTOJMË PËRDORIM GJUHËN

GJUHA SHQIPE 7

për klasën e shtatë të shkollës fillore nëntëvjeçare

LIBRI I MËSUESIT

КОМУНИЦИРАМО И САСТАВЉАМО УПОТРЕБЉАВАМО ЈЕЗИК

АЛБАНСКИ ЈЕЗИК 7

за седми разред деветогодишње основне школе

ПРИРУЧНИК

Botuesi: Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë

*Kryeredaktore dhe
redaktore përgjegjëse:* Natasha Zhivković

Redaktor: Zarija Brajović

Recensentë: Prof. dr. Mark Camaj
Mr. Rrok Gjollaj
Qamil Maraj, mësues i lëndës mësimore
Prof. dr. Fatmir Vadahi, pedagog
Prof dr. Vehbi Hoti, psikolog

Ilustrimet: Darko Dërleviq

Disenjoja dhe faqosja: Sasha Protiq

Korrektor: Dimitrov Popović

Redaktor teknik: Rajko Radulloviq

Për botuesin: Nebojsa Dragović

Shtypur në: Studio “Mouse”, Podgoricë

Tirazhi: 50

ISBN: 978-86-303-1214-4

Këshilli i Arsimit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 04-3-251 të datës 5.10.2007. e ka miratuar këtë tekst mësimor për përdorim në shkollat fillore nëntëvjeçare.

PASQYRE E LËNDËS

KAPITULLI I PARË

1.	Biseda telefonike	5
2.	Gjuha letrare dhe dialektet	6
3.	Kuptimi i fjalëve	8
4.	Sinonimet, antonimet dhe homonimet.	10

KAPITULLI I DYTË

5.	Biografia	12
6.	Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë	14
7.	Fjalìa e thjeshtë minimale dhe e zgjeruar	16
8.	Llojet e fjalive	18
	Punë e pavarur.	20

KAPITULLI I TRETË

9.	Tregimi	21
11.	Fjalitë dykryegjymtyrëshe	23
12.	Fjalitë njëkryegjymtyrëshe emërore.	25
13.	Fjalitë njëkryegjymtyrëshe foljore	27
14.	Kryefjala	29
15.	Kallëzuesi	31

KAPITULLI I KATËRT

16.	Lajmi dhe njoftimi	33
17.	Përcaktori	35
18.	Ndajshtimi.	37
19.	Kundrinori.	39
20.	Përcaktori kallëzuesor.	41

KAPITULLI I PESTË

20.	Përshkrimi.	43
21.	Rrethanorët.	45
22.	Rrethanorët e vendit dhe të kohës	46
23.	Rrethanorët e shkakut dhe të qëllimit	48
24.	Rrethanorët e mënyrës dhe të sasisë	50

KAPITULLI I GJASHTË

25.	Letra	52
26.	Ftesa	54
27.	Justifikimi	56
28.	Rendi i gjymtyrëve të dyta.	58
29.	Shkronja e madhe tek emrat	60
30.	Shkrimi i datave	62

Në vend të parathënies

Kompleti i teksteve të gjuhës amtare për klasën e shtatë përbëhet nga *Libri i nxënësit* dhe *Fletorja e punës* si dhe *Libri mësuesit*. Ata janë vazhdim i kompletit të teksteve të gjuhës amtare për klasën e gjashtë. Parimi bazë i punës në klasën e shtatë do të jetë ai i klasës së gjashtë. Nxënësve nuk do t'u jepen të gatshme dhe t'i mësojnë përmendsh rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore, por do t'i zbulojnë ato gjatë procesit mësimor dhe do të aftësohen t'i zbatojnë në praktikën e gjuhës së folur dhe të shkruar.

Libri i nxënësit ka gjashtë kapituj. Çdo kapitull ka një ose dy mësimë që i kushtohen gjuhës së folur dhe të shkruar : *bisedat telefonike, biografia, tregimi, përshkrimi, lajmi dhe njoftimi, letra, ftesa dhe justifikimi*. Këto mësimë do t'i aftësojnë nxënësit të lexojnë, analizojnë dhe kuptojnë tekste të llojeve të ndryshme, kryesisht joletrare, si edhe veçoritë e ndërtimit e të funksionimit të tyre si mjet komunikimi me gojë ose me shkrim.

Mësimet për gramatikën dhe drejtshkrimin, zakonisht, fillojnë me një tekst ose me disa fjali, pas të cilave vijnë pyetjet të cilat bëjnë të mundur, që të arrihet në përfundimet gramatikore që përbëjnë njohuritë e reja që do të përvetësohen. Në këtë mënyrë nxënësi mësohet që të arsyetojë dhe t'i zbulojë vetë njohuritë e reja. Pra, përmes pyetjeve kalohet nga e njohura në të panjohurën, duke nxitur kështu mësimin logjik të nxënësit dhe aftësinë e konkludimit. Në ndonjë rast janë përdorur si bazë nisjeje për kuptimin e nocioneve gjuhësore tabela ose skema, që bëjnë të mundur shqyrtimin e problemit gramatikor ose drejtshkrimor që do të mësohet. Në përgjigje të pyetjeve të mësuesit, nxënësit thonë lirisht mendimet e tyre, arsyetojnë përgjigjet, dallojnë çfarë është e drejtë dhe e gabuar në përgjigjet e tyre, dallojnë ku është gabimi dhe bëjnë vetë korrigjimin e gabimeve të tyre. Në këtë mënyrë ata arrijnë vetë në përfundime të drejta; kështu bëhet e mundur që njohuritë e fituara të jenë të qëndrueshme. Jo gjithmonë nxënësit nxjerrin përfundimet e dëshiruara. Në këto raste është e nevojshme ndihma dhe ndërhyrja e mësues-it/es. Mësuesi në këto raste mund të bëjë edhe pyetje plotësuese. Nxënësit nuk duhet të mësojnë përmendsh të dhënat dhe përkufizimet. E rëndësishme është njohja e fenomeneve gjuhësore, dallimi i rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore dhe, veçanërisht, zbatimi praktik i tyre.

Në fund të çdo kapitulli ndodhet një përmbledhje e shkurtër e lëndës së mësuar. Në librin e nxënësit janë parashikuar edhe dy projekte a punë të pavarura, në të cilët nxënësit duhet të zbatojnë gjithçka që kanë mësuar në kuadër të mësimit përkatës dhe të krijojnë diçka të re (biografia, faqja e gazetës).

Fletorja e punës është e ndarë në të njëjtat tërësi si edhe *Libri i nxënësit*, sepse është paraparë për punë krahas *Librit*. Detyrat janë renditur nga më të lehtat tek më të vështirat.

Nuk është e thënë që të gjithë nxënësit duhet t'i zgjidhin saktë të gjitha detyrat (kjo varet nga interesimi dhe aftësitë e tyre). Mësuesi mund të hartojë vetë teste me të cilat të verifikojë dhe të përforcojë njohuritë dhe shprehitë e fituara. Libri nuk ka detyra shtëpie. Nuk janë harruar, por kemi synuar që përparësi t'i japim punës në shkollë. Sigurisht mësuesi/ja mund të japë detyra shtëpie.

Libri i mësuesit jep në detaje procedurën që sugjerohet të ndiqet për çdo mësim dhe me të gjitha shpjegimet e nevojshme për çdo orë mësimi. Ata janë dhënë si modele, por mësuesi nuk është i detyruar t'i zbatojë ato. Mësuesi është i lirë të largohet nga modeli në masën që e sheh të arsyeshme, duke ua përshtatur metodën e punës nxënësve, kushteve konkrete të punës dhe metodës së punës së tij.

Në *Librin e mësuesit* janë planifikuar edhe orët mëimore për zbatimin e programit, po edhe këto nuk janë të detyrueshme. Mësuesit mund t'i ndryshojnë e t'i pajtojnë me veçoritë konkrete të nxënësve e klasës së tyre.

Mësimi 1

Bisedat telefonike

Ora e parë

Synimi: të dallojnë bisedat telefonike zyrtare dhe jozyrtare, të përgatisin vetë biseda të ngjashme dhe të marrin pjesë në to.

Janë të nevojshme: dy biseda të regjistruara në magnetofon, një zyrtare dhe një jozyrtare.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- bisedon me nxënësit për karakteristikat e bisedimit telefonik zyrtar dhe jo zyrtar;
- u kërkon të dëgjojnë dy regjistrime në magnetofon dhe të përcaktojnë në se janë zyrtare ose jozyrtare;
- u thotë të lexojnë dy tekstet nga *Libri i nxënësit*, fq. 6; u kërkon të thonë për secilën nga dy bisedat se kush flet, se me kë flet dhe për çfarë flet. I pyet nëse ndryshon mënyra e të folurit në këto dy biseda dhe në qoftë se po, ku ndryshon dhe pse ndryshon. I pyet: *Çfarë marrëdhëniesh ka ndërmjet bashkëbiseduesëve në të dy tekstet? Pse në bisedën e parë folësi nuk prezantohet? Bisedat janë zyrtare apo jozyrtare?* dhe u kërkon ta argumentojnë përgjigjen;
- nxjerrin konkluzionin që në rastin e parë flet një nxënëse me një person zyrtar. Në rastin e dytë flet një nxënëse me shoqen e saj, që mënyra e të folurit në telefon ndryshon në vartësi të personit me të cilin flasim, që nuk flasim njësoj me një person zyrtar dhe me një shok, që në rastin e parë nxënësi flet me një person zyrtar, kurse në rastin e dytë me një shoqe, që mënyra e të folurit në telefon ndryshon edhe në vartësi të problemit për të cilin flasim. Nuk flasim njësoj për një problem zyrtar dhe për një problem privat. Biseda telefonike, pra, mund të jetë: *zyrtare* ose *jozyrtare*. Kjo shihet: në mënyrën e prezantimit të bashkëbiseduesëve, në kulturën e tyre të të folurit dhe nga mënyra sesi i drejtohen ata njëri-tjetrit (në njëjës apo në shumës) dhe nga fjalët që përdorin;
- u kërkon të përgatisin për dhjetë minuta, në çifte, nga një bisedë telefonike zyrtare dhe ta paraqesin para klasës;
- vazhdon biseda rreth bisedimeve telefonike që nxënësit kanë përgatitur në klasë, duke u përqendruar në analizën e kulturës së të folurit.
- u kërkon të zgjidhin ushtrimet 1-4 në *Fletoren e punës*, fq. 5, 6 .

Shënim: u jep detyrë shtëpie të lexojnë të dhënat e nxjerra nga enciklopedia për fëmijë për telefonin dhe, në qoftë se e sheh të arsyeshme, mund të organizojë një orë të veçantë lidhur me këtë problematikë.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Gjuha letrare dhe dialektet

Ora e parë

Synimi: të njohin veçoritë e gjuhës letrare dhe të dialekteve të shqipes dhe të shkruajnë tekste në shqipen letrare.

Janë të nevojshme: dy biseda të regjistruara në magnetofon, një dialektore në familje dhe një letrare nga radioja ose televizioni.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon nga nxënësit të thonë, nëse gjuha që ata flasin në shtëpi me prindërit ose në rrugë me shokët, ndryshon nga gjuha që flitet në radio e televizion ose nga gjuha e librave të shkollës dhe pse ndryshon;
- udhëzon nxënësit të dëgjojnë incizimet që ka përgatitur, njëri në dialekt dhe tjetri në gjuhën letrare;
- kërkon nga nxënësit të thonë se çfarë dallimesh vënë re në mes bisedës së parë dhe të dytë;
- i fton nxënësit të vështrojnë dy variantet e të njëjtit tekst në *Librin e nxënësit* fq. 9;
- bën pyetjet: *A është i njëjti tekst? Çfarë ndryshimesh vini re ndërmjet këtyre dy varianteve? Cili ju duket më i afërt me gjuhën e përdorur në televizion, në libra dhe në revista?* dhe u kërkon t'i argumentojnë mendimet e tyre;
- nxjerrin përfundimet që është i njëjti fragment i shkruar në dy variante, që varianti i parë (A) është shkruar në gjuhën letrare dhe që varianti i dytë (B) është shkruar në *dialektin e Veriut* ose në *gegërisht*, që gjuha letrare është ajo që mësohet në *shkollë* dhe përdoret në *libra, gazeta, revista, radio, televizion, në shkencë, kulturë* etj., që duke përdorur *gjuhën letrare*, njerëzit merren vesh më lehtë dhe më mirë me njëri-tjetrin.

Ora e dytë

Synimi: të përforcojnë dhe të zgjerojnë shkallën e njohurive për gjuhën letrare dhe dialektet.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të vështrojnë tabelën në *Librin e nxënësit*, fq. 10;
- bën pyetjet: *Sa dialekte ka gjuha shqipe? Çfarë dallimesh fonetike ka ndërmjet tyre? Çfarë dallimesh morfologjike ka ndërmjet tyre? Me cilin dialekt është më afër gjuha letrare?;*
- nxjerrin përfundimin që gjuha shqipe ka dy dialekte: *gegërishten* ose *dialektin e Veriut* dhe *toskërishten* ose *dialektin e Jugut*, që ndryshimet më të mëdha ndërmjet dy dialekteve të shqipes janë në *fonetikë*, që dallimet kryesore në fonetikë ndërmjet dy dialekteve të shqipes janë: geg. *â, ê, n, vo, ue* - tosk. *ë, e, va, ua*, kurse në morfologji: geg. *due me punue* – tosk. *dua të punoj*; që gjuha letrare shqipe është më afër me *toskërishten*.
- u thotë të vështrojnë tabelën për leksikun në *Librin e nxënësit* fq. 10;
- bën pyetjet: *Cilat janë dallimet në leksik të dy dialekteve të shqipes? Me cilin dialekt është më afër gjuha letrare?;*
nxjerrin përfundimin që dy dialektet e shqipes kanë edhe dallime leksikore dhe që gjuha letrare shqipe edhe në fushën e leksikut është më afër me *toskërishten*.
- kërkon nga nxënësit të zgjidhin ushtrimet 1-5 në *Fletoren e punës*, fq. 5, 6.

Shënim: Për detyrat e shtëpisë që mund të japë, mësuesi është i lirë të vendosë vetë në varësi nga nevojat dhe mundësitë e fëmijëve. E rëndësishme është që detyrat e shtëpisë të jenë të arsyeshme dhe të menduara mirë.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Kuptimi i fjalëve

Ora e parë

Synimi: të mësojnë të dallojnë kuptimet e ndryshme të fjalëve.

Eshtë i nevojshëm: një fjalor shpjegues i gjuhës shqipe.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë në fjalorin e gjuhës shqipe çfarë thuhet për fjalën faqe ose një fjalë tjetër, që ai e gjykon të arsyeshme dhe organizon diskutimin rreth kuptimeve të saj;
- nxjerrin përfundimin që fjalët kanë shumë kuptime, të cilat ndryshojnë sipas kontekstit në të cilin përdoren;
- i fton nxënësit që të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 11 tri fragmentet që përmbajnë fjalën *faqe*;
- u kërkon të vështrojnë fjalën *faqe* të përdorur në tri tekstet;
- bën pyetjet: *Çili është kuptimi i fjalës faqe në pjesën e parë? Po në pjesën e dytë dhe të tretë, cili është kuptimi i fjalës faqe? Përse ndryshon kuptimi i fjalës faqe në tri pjesët? Cili është kuptimi i parë ose i vjetër i fjalës faqe?*;
- nxjerrin përfundimet që fjala *faqe* është përdorur në kontekste të ndryshme, që në kontekstin e parë tregon *pjesët anësore të fytyrës së njeriut*; në të dytin *pjesën e përparme të një kodre*; në të tretin *një anë të fletës së gazetës* dhe që kuptimi *faqe njeriu* është më i vjetër se dy kuptimet e tjera;

Ora e dytë

Synimi: të mësojnë të dallojnë kuptimet e figurshme të fjalëve.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë fjalitë *Të rinjtë, me punën e tyre, ia ndryshuan faqen vendit. Ai është krejt i pa fytyrë* në *Librin e nxënësit*, fq. 11;
- bën pyetjet: *Çfarë kuptimi ka fjala faqe në fjalinë e parë? Po fjala fytyrë në fjalinë e dytë, çfarë kuptimi ka?*;
- nxjerrin përfundimin që fjalët *faqe, fytyrë*, përveç se në kuptimin e tyre të drejtpërdrejtë për të shënuar pjesë të trupit të njeriut, përdoren edhe me kuptim të figurshëm, e para në kuptimin *pamje*, e dyta në kuptimin *nder, cipë* dhe që kuptimi i figurshëm i fjalëve përdoret kryesisht në krijimet poetike;
- rithekson përfundimet që shumë fjalë të gjuhës shqipe kanë disa kuptime, që disa kuptime të fjalëve janë më të vjetra dhe disa më të reja, që një fjalë mund të ketë disa kuptime dhe kuptim të figurshëm;
- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-6 në *Fletoren e punës*, fq. 7,8.

Shënim. Ndarja e propozuar e mësimave në orë mësimi, nuk është detyrueshme për mësuesin/en, sepse çdo klasë ka veçoritë e saj dhe ritmet e saj të përvetësimit të njohurive dhe çdo mësues përvojën e tij. Pra, mësuesit janë plotësisht lirë të vendosin vetë për sasinë dhe mënyrën e ndarjes së orëve për çdo mësim. Pra, nëse mësues-i/ja e sheh të nevojshme, mund të përdorë edhe një orë tjetër mësimi për këtë ose atë temë.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Sinonimet, antonimet dhe homonimet

Ora e parë

Synimi: të mësojnë të lexojnë tekste dhe të dallojnë sinonimet, antonimet dhe homonimet dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Janë të nevojshme: ilustrime të ndryshme me pamje nga Mali i Zi dhe nga vendlindja e nxënësve
Veprimtaritë e mësues-it/es:

- i pyet nxënësit se çfarë dinë ata për bukuritë e Malit të Zi dhe të vendlindjes së tyre;
- i fton nxënësit që të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 12 tekstin «Liqeni i Plavës»;
- bën pyetjet: *Për çfarë flitet në këtë tekst? A keni qenë në qytetin e Plavës dhe a e keni parë liqenin e tij? Nëse nuk keni qenë, si e përfytyroni bukurinë e këtij liqeni?*;
- u kërkon të vështrojnë fjalitë me shkronja blu dhe bën pyetjet: *Çfarë kuptimi kanë fjalët soditja, shikoja, kundruan? A mund ta zëvendësojnë ato njëra-tjetrën?* dhe u kërkon ta provojnë. I pyet se çfarë dallimi kuptimor kanë fjalët *hynin* dhe *dilnin*;
- nxjerr përfundimet që fjalët *shikoj, shoh, sodis, kundroj* që kanë kuptim të njëjtë ose shumë të afërt janë *sinonime*, që ato mund të zëvendësojnë njëra-tjetrën pa i ndryshuar kuptimin fjalisë ose paragrafit të dhënë, që fjalët *hynin* dhe *dilnin* që kanë kuptim të kundërt janë *antonime*;
- u kërkon të lexojnë në *Tekstin e nxënësit*, fq. 12 fjalitë: *U nis me veturë për në Budva. U nis me automobil për Budva. Ata u larguan pa ardhur policia. Ata u zhdukën pa ardhur policia Njeriu i ditur nuk është njësoi, me njeriun e paditur. Andin e zuri akrepi. Akrepi shënonte orën pesë pa dhjetë.*
- bën pyetjet: *A kanë të njëjtin kuptim çiftet e fjalëve me shkronja blu? Çfarë janë çiftet e fjalëve me shkronja blu?*;
- nxjerrin përfundimet që sinonimet kanë zakonisht një dallim të vogël përdorimi: *veturë* është më e përdorshme se *automobil*, kurse *largohu* dhe *zhduku* nuk mund të përdoren në të njëjtën situatë, që antonimet mund të jenë të formuara edhe nga e njëjta fjalë me anë të një parashtese me kuptim mohues: *dituri*–*padituri*, *besim*–*mosbesim*, *shkencor*–*joshkencor*, *qep*–*shqep*, *veprim*–*kundërveprim*, që jalët *akrep* në kuptimin *insekt* dhe *akrep* në kuptimin *pjesë e orës*, të cilat shkruhen e shqiptohen njësoj, por kanë kuptime të ndryshme, janë *homonime*. Po kështu *bankë* (banka e shtetit) dhe *bankë* (banka e klasës). Bën kujdes që të mos ngatërrojnë *sinonimet* me *homonimet*, rithekson që sinonimet janë fjalë të ndryshme që kanë kuptim të njëjtë ose të përafërt (*fshat* – *katund* / *vajzë* – *çupë* etj.), kurse *homonimet* fjalë që shkruhen ose shqiptohen *njësoj*, por kanë *kuptime të ndryshme* (*bel-i-pjesë e trupit të njeriut* – *bel-i-vegël për të punuar tokën*).

Ora e dytë

Synimi: të zbatojnë gjithçka që është mësuar për sinonimet, antonimet dhe homonimet.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- kërkon të bëjnë ushtrimet 1-5 në *Fletoren e punës* rreth 20-25 minuta. Gjatë 15-20 minutave të tjera, bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.
- jep si detyrë shtëpie ose, në qoftë se e gjykon të arsyeshme, e bën objekt të një ore të veçantë mësimi ushtrimin 6 në *Fletoren e punës*.

Shënim: Për përforcimin e lëndës së mësuar në fund të çdo kapitulli mësuesi është i lirë të vendosë vetë në varësi nga shkalla e përvetësimit të njohurive. E rëndësishme është që koha dhe ushtrimet që do të japë për verifikimin dhe përforcimin e njohurive të jenë të arsyeshme dhe të menduara mirë

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 5

Biografia

Ora e parë

Synimi: të zhvillojnë aftësinë për të lexuar dhe kuptuar biografi dhe autobiografi.

Janë të nevojshme: ilustrime të ndryshme nga jeta dhe veprimtaria e Aleksandër Moisiut.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të thonë se çfarë është biografia, nëse kanë lexuar ndonjë vepër biografike, për cilin personalitet të kulturës ose shkencës botërore, shqiptare ose malazeze ka qenë, çfarë të dhënash përmbante etj.;
- u kërkon të flasin për Aleksandër Moisiun, i pyet, nëse kanë dëgjuar ose lexuar diçka për jetën dhe veprimtarinë e tij;
- u kërkon të hapin *Librin e nxënësit*, fq. 16 dhe të lexojnë tekstin për Aleksandër Moisiun;
- bën pyetjet: *Për kë flitet në këtë tekst? Kur ka lindur Aleksandër Moisiu? Ku ka lindur? Ku ka jetuar? Cila është veprimtaria e tij?*
nxjerrin përfundimin se Aleksandër Moisiu ka qenë një personalitet i jetës artistike evropiane;
bën pyetjet: *Nga është marrë ky tekst? A ka personazhe në këtë tekst? A paraqiten në këtë tekst përjetimet shpirtërore, dëshirat, gëzimet, ndjenjat e Aleksandër Moisiut? Çfarë teksti është ky letrar apo joletrar? Në këtë tekst: tregohet ngjarja që ka hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen, flitet për jetën e dikujt? Në çfarë vete është shkruar ky tekst? Çfarë është ky tekst: tregim, përrallë, biografi?*
- nxjerrin përfundimet që në këtë tekst flitet për jetën dhe veprën e Aleksandër Moisiut, kur ka lindur, ku ka lindur, koha kur ka jetuar, veprimtaria që ka kryer, që ai është shkruar në vetën e tretë, që teksti për Aleksandër Moisiun është *biografi*, që biografia mund të tregojë gjithë jetën e një njeriu ose pjesë të saj, ngjarje të veçanta të saj, që ka biografi artistike dhe shkencore, që në biografitë artistike përshkruhet jeta e një personi të rëndësishëm në një epokë të caktuar, me gjuhën dhe në stilin e veprave letrare, kurse në biografitë shkencore vëmendja përqendrohet më shumë në veprimtarinë shoqërore të personit, sesa në jetën private të tij, pra, nuk jepen përjetimet shpirtërore, dëshirat, gëzimet ose ndjenjat e personit për të cilin flitet, që në biografitë shkencore gjuha dhe stili i të shkruarit të tyre është i thjeshtë;

Ora e dytë

Synimi: të përforcojnë njohuritë për biografinë, ta dallojnë atë nga llojet e tjera të teksteve si autobiografia, portreti etj. dhe të projektojnë e zbatojnë gjithçka të mësuar për biografinë.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-6 në *Fletoren e punës*, fq. 12, 13 dhe verifikimin e tyre;
- u jep si detyrë të mbledhin të dhëna për biografinë e shkrimtarit të tyre të preferuar, të mbledhin të dhëna për jetën e tij dhe veprat e tij si edhe për vlerësimet e bëra për veprën e tij nga studiues të ndryshëm dhe t'i grupojnë në një tabelë, sikurse tek ushtrimi nr. 4, fq. 12 në *Fletoren e punës*.
- kërkon nga çdo nxënës që mbi bazën e të dhënave që ka grumbulluar për shkrimtarin e tij të preferuar për 20- 25 minuta të hartojë biografinë e tij;

pas 20-25 minutash u thotë që secili të paraqesë punën e tij;

- u kërkon të lexojnë disa prej tyre;
- bëhet vlerësimi dhe korigjimi i tyre mbi bazën e përvojës së fituar;
- në fund, zgjidhet biografia më e mirë.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë

Ora e parë

Synimi: të përforcojnë njohuritë e fituara në klasë të gjashtë për ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë dhe të aftësohen më tej për të dalluar ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë dhe për t'i përdorur drejt ato në gjuhën e tyre të folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të thonë se çfarë është ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë dhe u kërkon shembuj;
- u kërkon të vështrojnë figurat në *Librin e nxënësit*, fq. 17 dhe të lexojnë përkatësisht fjalët e Agronit në gjyq dhe fjalët e Agronit, të ripërsëritura nga Gazmendi;
- bën pyetjet: *Kush flet në figurën e parë? Çfarë i thotë Agroni gjyqtarit? Kush flet në figurën e dytë? Me kë flet Gazmendi? Çfarë i thotë ai Lirës? A ka ndryshim ndërmjet fjalëve të thëna nga Agroni dhe të fjalëve të Agronit të përsëritura nga Gazmendi? Çfarë janë fjalët “Unë kam qenë në shtëpi atë natë. Ju nuk keni prova kundër meje.”, të thëna nga Agroni dhe të riprodhuara me saktësi nga Gazmendi?;*
- nxjerrin përfundimin që fjalët e thëna nga dikush e të riprodhuara me saktësi nga një person tjetër, janë *ligjëratë e drejtë*.
- nxjerrin përfundimin që fjalët e thëna nga dikush të riprodhuara të ndryshuara nga një person tjetër, janë *ligjëratë e zhdrejtë*.

Ora e dytë

Synimi: të përforcojnë njohuritë për ligjëratën e drejtë dhe të zhdrejtë dhe të njohin shenjat kryesore të pikësimit që përdoren në ligjëratën e drejtë.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë të shkruara në tabelë ose në *Librin e nxënësit*, fq. 17 fjalitë: *Agroni tha: “Unë kam qenë në shtëpi atë natë. Ju nuk keni prova kundër meje.” Agroni tha se ai kishte qenë në shtëpi atë natë dhe se ata nuk kishin prova kundër tij;*
- bën pyetjet: *A është e njëjta ligjëratë në të dy rastet? Çfarë ligjërata është e para? Çfarë ligjërata është e dyta? Çfarë dallimesh vini re ndërmjet ligjëratës së drejtë dhe të zhdrejtë?;*
- nxjerrin përfundimin që ligjërata e parë është *e drejtë*, kurse e dyta *e zhdrejtë*, që gjatë kthimit të ligjëratës së drejtë në ligjëratë të zhdrejtë, fjalët e autorit kthehen në një fjali të përbërë me pjesë të nënrenditura, ndryshojnë format e foljeve (*kam qenë - kishte qenë, keni - kishin*) dhe përemrat vetorë (*unë – ai, meje - tij*);
- u kërkon të lexojnë fjalitë në vijim: *I. Populli thotë: “Më mirë një vezë sot se një pulë mot.”; II. “Më mirë një vezë sot se një pulë mot”, - thotë populli.; III. “Sa u lodha sot!” - tha Blerta. “Kur do të shkojmë?” - pyeti Zana.;*
- bën pyetjet: *Çfarë shenjash pikësimi vini re para dhe pas ligjëratës së drejtë në fjalinë e parë? Çfarë shenjash pikësimi vini re para dhe pas ligjëratës së drejtë në fjalinë e dytë? Pse ndryshojnë shenjat e pikësimit në këto dy ligjërata të drejta? Po në dy fjalitë e fundit çfarë shenja pikësimi vini re?;*
- nxjerrin përfundimin që, kur ligjërata e drejtë qëndron pas fjalëve të autorit, para saj vihen dy pika, fjala e parë e ligjëratës së drejtë fillon me shkronjë të madhe dhe ligjërata e drejtë vihet midis thonjëzash, që, kur ligjërata e drejtë qëndron para fjalëve të autorit, ajo vihet

midis thonjzash dhe pas saj vihet presje dhe vizë dhe fjalët e autorit fillojnë me shkronjë të vogël. Po kështu, në qoftë se ligjërata e drejtë është fjali pyetëse ose nxitëse, në fund të saj vihet pikëpyetje ose pikëçuditje dhe vizë.

Ora e tretë

Synimi: të përforcojnë njohuritë për ligjëraten e drejtë dhe të zhdrejtë dhe të njohin shenjat kryesore të pikësimit që përdoren në ligjëraten e drejtë.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u thotë të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 18 ose të shkruara më parë ose në tabelë, fjalitë: I. “Rrini, - më thoshte, - se do të vinë dhe fëmijët.” II. “Rrini se do të vinë edhe fëmijët, - më thoshte. - Ata nuk do të vonohen.” III. “E ke parë filmin ? - pyeti kameramani. - Është me të vërtetë i bukur.”
- bën pyetjet : *Cila është ligjërata e drejtë në tre shembujt e mësipërm? Ku janë vendosur fjalët e autorit në të tri rastet? Çfarë shenjash pikësimit përdoren, kur fjalët e autorit janë futur në mes të ligjërates së drejtë?*
- nxjerrin përfundimet që, kur fjalët e autorit futen në mes të ligjërates së drejtë përdoren këto shenja pikësimit: a) në qoftë se ligjërata e drejtë është një fjali (e thjeshtë ose e përbërë), para dhe pas fjalëve të autorit vihet presje dhe vizë; b) në qoftë se pjesa e dytë është një fjali tjetër, atëherë pas fjalëve të autorit vihet pikë dhe vizë; c) në qoftë se pjesa e parë e ligjërates së drejtë është fjali pyetëse ose nxitëse, ajo mbaron me pikëpyetje ose pikëçuditje. Para fjalëve të autorit vihet vizë, pas tyre pikë dhe vizë.
- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-4 në *Fletoren e punës*, fq. 14.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Fjalìa e thjeshtë

Ora e parë

Synimi: të mësojnë të dallojnë fjalinë e thjeshtë minimale dhe të zgjeruar dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të thonë çfarë dinë për fjalinë, çfarë janë fjalitë e thjeshta, ku dallohen nga fjalitë e përbëra dhe të japin shembuj fjalish të thjeshta dhe të përbëra;
- kërkon nga nxënësit të lexojnë të shkruar në tabelë ose në Librin e nxënësit, fq. 19 fjalinë: *Astriti lexon rregullisht në bibliotekën e qytetit revistat e reja për të rinj.*;
- bën pyetjet: *Sa folje ka kjo fjali? Çfarë fjalie është? Cila është kryefjala e kësaj fjalie? Cili është kallëzuesi? Çfarë janë fjalët e tjera?*;
- nxjerrin përfundimin që fjalìa e mësipërme është e thjeshtë, sepse ka një folje dhe ka kuptim të plotë;
- u kërkon të lexojnë fjalitë: *I huaji u ngrit dhe shkoi pa e filluar punën. Vetëm ne mund të flasim me përgjegjësi për atë. Ardiani filloi të fliste me zë të lartë. Pushoi për të pushuar deri në mëngjes, po në mëngjes u ngrit herët.*;
- bën pyetjet: *Sa folje ka secila nga këto fjali? Çfarë fjalish janë?*
- nxjerrin përfundimin që fjalìa është e thjeshtë edhe kur ka dy ose më shumë folje homogjene (që kanë të përbashkët, përveç kryefjalës, të paktën, edhe një gjymtyrë të dytë), edhe kur folja paraprihet nga një folje modale (duhet, mund) ose një folje aspektore (filloj, nis) që shënon fillimin, vazhdimin ose mbarimin e një veprimi, por edhe kur ndërtohet me një formë foljore të përsëritur;
- u kërkon të vështrojnë dhe komentojnë skemën që provon se fjalìa e thjeshtë mund të ketë një folje, dy folje homogjene, një folje modale plus një folje tjetër, një folje aspektore plus një folje tjetër dhe një folje të përsëritur;
- u kërkon të lexojnë fjalitë e grupuara në A dhe B. Bën pyetjet: *Sa folje ka secila? Çfarë fjalish janë? A mund të heqim fjalë nga këto fjali të thjeshta dhe fjalitë të kenë kuptim? Çfarë fjalish të thjeshta janë dy fjalitë e para? Çfarë fjalish të thjeshta janë tri fjalitë e dyta?* nxjerrin përfundimet që dy fjalitë e para që kanë nga një folje dhe nga të cilat mund të heqim fjalë, pa e bërë të pakuptueshme fjalinë, janë *fjali të thjeshta të zgjeruara*, që tri fjalitë e dyta, që kanë nga një folje dhe nga të cilat nuk mund të heqim asnjë fjalë se fjalìa bëhet e pakuptimshme janë *fjali të thjeshta minimale*.
- u kërkon të vështrojnë dhe komentojnë skemën që provon se fjalìa e thjeshtë mund të jetë minimale dhe e zgjeruar;

Ora e dytë

Synimi: të zbatojnë gjithçka që është mësuar për fjalinë e thjeshtë dhe të përbërë.

Janë të nevojshme: ilustrime të ndryshme nga jeta dhe vepra e Edit Durham.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- zhvillon një bisedë rreth udhëpërshkrimeve, i pyet nëse kanë pasur rastin të lexojnë nonjë tekst ku paraqiten përshtypje të udhëtarëve që kanë vizituar Malin e Zi ose Shqipërinë, nëse e kanë dëgjuar emrin e udhëtares angleze Edit Durham dhe, nëse dinë diçka për jetën

dhe veprën e saj;

- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit* tekstin: “*Edith Durham (1863-1944)*”;
- bën pyetjet: *Për kë flitet në këtë tekst? Kur dhe ku ka lindur Edit Durham? Çfarë librash ka shkruar? Përse flitet në librat e saj?* dhe u kërkon të dallojnë fjalitë e thjeshta minimale, të zgjeruara dhe të përbëra;
- u kërkon të bëjnë individualisht, në çifte ose në grupe, sipas rastit, ushtrimet 1-3 në *Fletoren e punës*, fq. 15. Pastaj bëhet kontrolli i saktësisë së ushtrimeve të zhvilluara.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Llojet e fjalive

Ora e parë

Synimi: të mësojnë të dallojnë llojin e fjalive sipas asaj që kumton, pra, fjalitë dëftore, pyetëse, dëshirore dhe nxitëse dhe t'i përdorin e lexojnë ato drejt në gjuhën e tyre të folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të flasim për ruajtjen e ambientit, sidomos të pyjeve. I pyet, nëse kanë pasur rast të shohin pyllin duke u djegur, si ka ndodhur dhe pse ka ndodhur dhe si do të vepronin ata, në rast se shohin se dikush ka ndezur zjarr në pyll ose se ka rënë zjarr në pyll;
- nxjerrin konkluzionin se ruajtja e ambientit, në këtë rast të pyjeve tona, është detyrë e të gjithëve dhe se kjo ka të bëjë me të sotmen dhe të ardhmen tonë;
- kërkon nga nxënësit të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 21 tekstin “Përgëzojeni të gjithë”;
- bën pyetjet: *Çfarë bën autori në këtë tekst? Cilat fjali japin një informacion ose tregojnë diçka? Çfarë fjalish janë ato që japin një informacion ose tregojnë diçka? Cilat fjali kërkojnë një sqarim ose pyesin për diçka? Çfarë fjalish janë ato që kërkojnë një sqarim ose pyesin për diçka? Cila fjali shprehin një dëshirë? Çfarë fjalish janë ato që shprehin një dëshirë? Cilat fjali nxitin dikë për të bërë diçka? Çfarë fjalish janë ato që nxitin dikë për të bërë diçka?;*
- nxjerrin përfundimin që fjalitë që tregojnë diçka ose që japin një informacion ose një mendim janë fjali *dëftore*, që fjalitë që pyesin për diçka ose që kërkojnë një sqarim janë fjali *pyetëse*, që fjalitë që shprehin një dëshirë, një urim ose një mallkim, janë fjali *dëshirore*, që fjalitë që nxitin ose ndalojnë dikë të zbatojë një urdhër, të japë një këshillë ose të bëjë një ftesë, janë fjali *nxitëse*.

Ora e dytë

Synimi: të përforcojnë njohuritë për llojet e fjalive sipas kumtimit dhe shenjat e pikësimit që duhen përdorur në fund të këtyre fjalive.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 22 fjalitë dëftore, pyetëse, dëshirore dhe nxitëse të nxjerra nga teksti i mësipërm dhe të vështrojnë shenjat e pikësimit;
- nxjerrin përfundimin që në fund të fjalive dëftore dhe nxitëse vihet pikë, në fund të fjalive pyetëse, pikëpyetje dhe në fund të fjalive dëshirore, pikëçuditje dhe që edhe në fund të fjalive nxitëse thirrmore vihet pikëçuditje (- *Përgëzojeni të gjithë!*);
- u kërkon të lexojnë dy fjalitë pyetëse në vazhdim: *A ishte mburravec Arviti? - Ku ishte, Arviti?;*
- bën pyetjet: *Çfarë fjalish janë? Cila nga këto fjali kërkon si përgjigje po ose jo? Çfarë fjalie pyetëse është ajo? Me se fillon fjalia pyetëse tërësore? A mund t'i përgjigjemi me po ose jo fjalisë së dytë? Ku përqendrohet pyetja në fjalinë e dytë? Çfarë fjalie pyetëse është fjalia e dytë?;*
- nxjerrin përfundimin që fjalia pyetëse që kërkon si përgjigje *po* ose *jo* është fjali pyetëse *tërësore*, të tjerat janë fjali pyetëse *të pjesshme*, që tek fjalia pyetëse tërësore kryefjala del shpesh pas foljes e në mjaft raste në fund të fjalisë dhe që tek kjo lloj fjalie mund të përdoren fjalët: *a, vallë, a mos;*
- u kërkon të vështrojnë skemën në vijim dhe të diskutojnë rreth përmbajtjes së saj;
- përforcojnë përfundimin që fjalitë e thjeshta mund të jenë: *dëftore, pyetëse, dëshirore* ose *nxitëse*, që fjalia *dëftore* tregon diçka, jep një informacion ose një mendim, që fjalia *pyetëse*

pyet për diçka ose kërkon një sqarim, që fjalia *dëshirore* shpreh një dëshirë, një urim ose një mallkim dhe që fjalia *nxitëse* nxit ose ndalon dikë të zbatojë një urdhër, të japë një këshillë ose të bëjë një ftesë;

- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-5 në *Fletoren e punës*, fq. 16, 17;

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Punë e pavarur

Ora e parë

Synimi: të fitojnë shprehitë e kërkimit dhe të punës së pavarur dhe të aftësohen të shkruajnë tekste jo letrare në mënyrë të pavarur mbi një tematikë të caktuar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- Mësuesi i ka njoftuar nxënësit me kohë që ora e ardhshme do të jetë punë e pavarur për jetën dhe veprën e shkrimtarit Ismail Kadare dhe u ka kërkuar të grumbullojnë të dhëna dhe dokumente për jetën dhe veprimtarinë e tij (koha dhe vendi i lindjes, studimet që ka kryer, veprimtaria letrare dhe shoqërore, veprat letrare, studiuesit e huaj dhe shqiptarë për veprën e tij etj).
- u kërkon të nxjerrin dokumentet dhe të dhënat që kanë grumbulluar për jetën dhe veprën e Ismail Kadaresë; e ndan klasën në 5/6 grupe me nga 3/4 nxënës secili. Nxënësit e çdo grupi në bashkëpunim me mësuesin vendosin se për çfarë aspekti të jetës së Kadaresë do të punojë secili grup: 1. Koha dhe vendi i lindjes; 2. Studimet që ka kryer; 3. Veprimtaria letrare dhe shoqërore; 5. Veprat letrare; 6. Studiuesit e huaj dhe shqiptarë për veprën e tij;
- u lë në dispozicion 35 minuta sepse 10 minuta vonon shpërndarja në grupe dhe shkëmbimi i literaturës.

Ora e dytë

Synimi: të aftësohen të shkruajnë tekste jo letrare në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim mbi një tematikë të caktuar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- përfaqësues të çdo grupi paraqesin rezultatin e punës së bërë. Çdo grup ka një kohë të caktuar në dispozicion për të paraqitur punën e vet.
- kërkon që nxënësit e tjerë të bëjnë vërejtje dhe të japin mendime për punën e bërë, duke aktivizuar sa më shumë nxënës.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 9

Tregimi

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të kuptojnë e analizojnë tekste dhe të mësojnë përmbajtjen e nocioneve *hyrje, zhvillim, mbyllje* dhe t'i zbatojnë ato në procesin e analizës së teksteve.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- duke iu referuar njohurive të fituara në klasën e gjashtë bën pyetjet: *Cilat janë format e shprehjes artistike? Cilat janë veçoritë e përshkrimit? Cilat janë veçoritë e tregimit?;*
- nxjerrin përfundimin që format kryesore të shprehjes artistike janë *tregimi dhe përshkrimi;*
- u thotë të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 29 tekstin “*Zilja e zhytur dhe flutura;*
- bën pyetjet: *Kush e ka shkruar tekstin “Zilja e zhytur dhe flutura”? Për kë flitet në këtë tekst? Çfarë thuhet për Zhan Domenik Bobin? Çfarë i kishte ndodhur atij në moshën 43 vjeçare? Si veproi ai për t'i dhënë kuptim jetës së tij? A ia arriti qëllimit?;*
- vijon me pyetjet: *Çfarë bën autori në këtë tekst? A renditen ngjarjet në mënyrë logjike dhe kronologjike? U kërkon ta argumentojnë mendimin e tyre. Pyet : Cila formë e të shprehurit artistik është përdorur në këtë tekst? Nga jeni nisur për të nxjerrë këtë përfundim? Cila është hyrja, zhvillimi dhe përfundimi në këtë tekst? Cila është pjesa më interesante e këtij teksti? U kërkon ta argumentojnë dhe i pyet se cila është tema ose problemi që trajtohet;*
- nxjerrin përfundimet që teksti “*Zilja e zhytur dhe flutura*” është një tregim, që të tregosh do të thotë të informosh bashkëfolësin për një seri ngjarjesh reale ose të imagjinuara të cilat pasojnë njëra-tjetrën dhe janë të lidhura me njëra-tjetrën, që tregimi ka *hyrjen* (tregohet vendi, koha dhe personazhet), *zhvillimin* (paraqitet një ngjarje ose një personazh që prish situatën fillestare dhe vijon me zhvillimin e ngjarjeve) dhe *mbylljen* ose përfundimin e ngjarjeve, që tema është problemi i paraqitur në një tekst letrar ose joletrar. Në tekstin “*Zilja e zhytur dhe flutura*” tema është “*jeta është një provë e aftësive të njeriut për t'i dhënë asaj kuptim edhe në kushte tepër të vështira*”.

Ora e dytë

Synimi: të aftësohen të kuptojnë e të analizojnë tekste dhe të mësojnë përmbajtjen e nocioneve *paraqitje ose ekspozim, pikë e lidhjes, zhvillim, pikë kulmore , zgjidhje* dhe t'i zbatojnë ato në procesin e analizës së teksteve.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u thotë të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 30 tekstin “*Fitorja të ringjallë;*”
- bën pyetjet: *Kush e ka shkruar tekstin? Për kë flet? Si fillon ngjarja? Si veproi djali për të realizuar mendimin e tij? A vijuan ngjarjet sipas parashikimit të tij? Çfarë gjë e papritur ndodhi? Si përfundon ngjarja? Çfarë bën autori në këtë tekst? Cila është në këtë tekst paraqitja ose ekspozimi? Cila është pika e lidhjes? Cili është zhvillimi? Cila është pika kulmore? Cila është zgjidhja? A janë reale ngjarjet e këtij teksti? A renditen ngjarjet sipas rendit të zhvillimit të tyre? Çfarë është ky tekst: një lajmërim, një përshkrim, një tregim? Në çfarë vete paraqitet ngjarja në tekstin e parë? Po në të dytin? Në cilin tekst ngjarja tregohet objektivist? Në njërën tekst autori shpreh mendimet dhe përshtypjet e veta. Në cilin?*
- nxjerrin përfundimin që subjekti i një tregimi ose vepre, është tërësia e ngjarjeve. Elementet përbërës të tij janë: *paraqitja ose ekspozimi, pika e lidhjes, zhvillimi, pika kulmore* dhe

zgjdhja. Paraqitja ose ekspozimi është pjesa e subjektit ku jepet situata fillestare që na përgatit për ngjarjet që do të ndodhin më pas: Më lindi një mendim i mrekullueshëm. Mora një levrek të madh nga ata që kisha nxjerrë, i çava barkun dhe i futa brenda një dinamit të tërë. Fitolin e lashë të gjatë...). Pika e lidhjes është momenti kur fillon konflikti kryesor ose ngjarja e papritur në: ... *Dhe në këtë kohë u dëgjua një plasje e thellë, si në fund të dheu...).* Zhvillimi është momenti kur konflikti ose ngjarja e papritur që është shfaqur, nis e shtjellohet dhe ngjarjet marrin jetë: *Peshkaqeni bëri dhjetëra rrokullisje të shpejta si helika gjigante e vaborit. Herë i dukej koka mbi det, herë i dukej bishti. Deti u turbullua, sikur po bëhej kiameti...).* Gjatë zhvillimit jepen në mënyrë kronologjike ngjarjet kryesore dhe për çdo ngjarje të rëndësishme personazhet kryesore. Pika kulmore është momenti kur zhvillimi i ngjarjeve, i konflikteve arrin pikën më të mprehtë: *Ai “përt” ia bëri dhe më rrëmbeu e më solli disa herë rrotull. Ngriti shpatën e tij mprehëse të qafës dhe më çau, mu këtu... në gjoks...).* Zgjdhja ose përfundimi vjen pas zhvillimit të ngjarjeve apo konfliktit : *Mblodha gjithë forcat e mia dhe me mundime mbinjerëzore arrita shkëmbin, ja, mu aty... U ngrita. Pashë se peshkaqeni ishte aty, i mbërthyer dhe i ngordhur. Kjo më gjallëroi. Ashtu është. Kur del fitimtar, njeriu, edhe i vdekur, ngjallet. Fitorja të ringjallë e të jep forca të reja.”* Tregimi mund të pasurohet me përshkrime, portrete, dialogë dhe mendime;

Ora e tretë

Synimi: të përforcojnë njohuritë për tekstet treguese dhe veçoritë e tyre.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-8 në *Fletoren e punës*, fq. 18, 19 dhe bëjnë vlerësimin e punës së tyre.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Fjalìa dykryegjymtyrëshe

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të dallojnë fjalitë e thjeshta dykryegjymtyrëshe, të përcaktojnë grupet kryesore përbërëse të tyre dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 32 tekstin “Një çikë mjaltë”;
- bën pyetjet: *Sa folje kanë fjalitë me shkronja blu? Çfarë fjalish janë fjalitë me shkronja blu? Sa folje kanë fjalitë me shkronja rozë? Çfarë fjalish janë fjalitë me shkronja rozë?*;
- nxjerrin përfundimin që fjalitë mund të jenë të thjeshta dhe të përbëra, që fjalitë e thjeshta kanë vetëm një folje në një nga mënyrat e zgjedhimit të saj (*Një fajdexhi i moshuar jetonte në një vend të largët. Ai ishte një koprrac i madh dhe i pashpirt.*), që fjalitë e përbëra përmbajnë dy ose më shumë grupe fjalësh që kanë secili një folje të zgjedhur (*Njerëzve /që u jepte borxh,/ u merrte përqindje të madhe. Po të mos ia kthenin borxhin në kohën e duhur/ rrëmbente gjithçka, shtëpi e katandi e çdo gjë tjetër.*);
- u thotë të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 32 fjalinë *Një fajdexhi i moshuar jetonte në një vend të largët.*;
- bën pyetjet: *Cilat janë grupet kryesore të fjalëve në këtë fjali? Çfarë tregon grupi emëror i kryefjalës Një fajdexhi i moshuar? Çfarë tregon grupi foljor jetonte në një vend të largët? Sa gjymtyrë ka kjo fjali? Si quhet fjalia e thjeshtë që ka dy gjymtyrë kryesore?*;
- nxjerrin përfundimin që fjalia e thjeshtë zakonisht është dykryegjymtyrëshe dhe përbëhet nga një grup emëror (GE) (*Një fajdexhi i moshuar*) dhe nga një grup foljor (GF) (*jetonte në një vend të largët*). Grupi emëror zakonisht ka si bërthamë një emër (fajdexhi) që kryen funksionin e kryefjalës, kurse grupi foljor ka si bërthamë një folje (jetonte) që kryen rolin e kallëzuesit.
- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 33 fjalitë: *Një fajdexhi i moshuar jetonte në një vend të largët. Një fajdexhi. Një koprrac i pashpirt.*;
- bën pyetjet: *Sa folje ka në fjalinë e parë? Çfarë fjalie është? A ka folje në dy fjalitë e dyta? Çfarë fjalish janë?*;
- nxjerrin përfundimin që fjalitë e thjeshta mund të jenë fjali të thjeshta me folje (*Një fajdexhi i moshuar jetonte në një vend të largët*) dhe fjali të thjeshta pa folje (*Një fajdexhi. Një koprrac i pashpirt.*);
- u thotë të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 33 fjalinë : *Një fajdexhi i moshuar jetonte në një vend të largët.*;
- bën pyetjet: *Cilat janë grupet kryesore të fjalëve në këtë fjali? Çfarë tregon grupi emëror i kryefjalës “Një fajdexhi i moshuar”? Çfarë tregon grupi foljor në “jetonte në një vend të largët”? Sa gjymtyrë ka kjo fjali? Si quhet fjalia e thjeshtë që ka dy gjymtyrë kryesore?*;
- nxjerrin përfundimin që fjalia e thjeshtë me folje zakonisht është dykryegjymtyrëshe, përbëhet nga një grup emëror (GE) dhe nga një grup foljor (GF) (*Një fajdexhi i moshuar (GE) jetonte në një vend të largët (GF)*) që grupi emëror zakonisht ka si bërthamë një emër (*një fajdexhi*) që kryen funksionin e kryefjalës, kurse grupi foljor ka si bërthamë një folje (*jetonte*) që kryen funksionin e kallëzuesit;
- vijon me pyetjet: *A mund të zgjerohet grupi emëror? Po të zvogëlohet a mundet? A mund të zgjerohet grupi foljor? Po të zvogëlohet a mundet? Dhe u kërkon që t'i vërtetojnë përgjigjet;*
- nxjerrin përfundimin që grupet emërore dhe grupet foljore mund të zgjerohen: (*Një fajdexhi i moshuar dhe zemërlig jetonte në një vend shumë të largët.*) dhe të zvogëlohen (*Një fajdexhi jetonte në një vend.*).

Ora e dytë

Synimi: të përforcojnë njohuritë e fituara për fjalinë dykryegjymtyrëshe përmes ushtrimesh me karakter praktik.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë fjalitë: *Një fajdexhi i moshuar jetonte në një vend të largët. Një fajdexhi. Një koprrac i pashpirt;*
- bën pyetjet: *Sa folje ka në fjalinë e parë? Çfarë fjalie është? A ka folje në dy fjalitë e dyta? Çfarë fjalish janë?;*
- nxjerrin përfundimin që fjalia e thjeshtë mund të jetë edhe *pa folje*.
- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-6 në *Fletoren e punës*, fq. 20, 21 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre .

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Fjalitë njëkryegjymtyrëshe emërore

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të dallojnë fjalitë e thjeshta njëkryegjymtyrëshe emërore dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë të shkruar në tabelë ose *Librin e nxënësit*, fq. 34 tekstin “Pranverë”;
- u thotë të veçojnë fjalitë dhe të gjejnë grupet emërore dhe grupet foljore të tyre;
- u kërkon t'i shkruajnë fjalitë në fletoren e tyre ose në tabelë dhe të nënvizojnë me një vijë grupet e kryefjalës e me dy vija grupet foljore. Bën pyetjet: *Cilat fjali i kanë të dyja gjymtyrët kryesore dhe cilat vetëm një të një nga dy gjymtyrët kryesore?*
- nxjerrin përfundimin që fjalitë zakonisht kanë grupin emëror të kryefjalës dhe grupin foljor që janë dy gjymtyrët kryesore të fjalisë, që fjalitë që kanë dy gjymtyrë kryesore quhen *dykryegjymtyrëshe* (*Të gjithë po vështronin të mahnitur.*), që ka edhe fjali që kanë vetëm një gjymtyrë kryesore. Këto fjali quhen fjali *njëkryegjymtyrëshe* (*Pranverë. Jashtë bënte fresk. etj*);
- u thotë të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 33 fjalitë njëkryegjymtyrëshe : *Pranverë. Jashtë bënte fresk.*;
- bën pyetjet: *Sa gjymtyrë kryesore ka fjalia e parë? Me se është shprehur gjymtyra kryesore në fjalinë e parë? Çfarë fjalie njëkryegjymtyrëshe është fjalia e parë? Sa gjymtyrë kryesore ka fjalia e dytë? Me se është shprehur gjymtyra kryesore në fjalinë e dytë? Çfarë fjalie njëkryegjymtyrëshe është fjalia e dytë?*;
- nxjerrin përfundimin që fjalitë njëkryegjymtyrëshe mund të jenë fjali njëkryegjymtyrëshe të shprehura me grup *emëror* (fjali njëkryegjymtyrëshe *emërore* ose thjesht fjali *emërore: Pranverë.*) dhe fjali njëkryegjymtyrëshe të shprehura me grup *foljor* (fjali njëkryegjymtyrëshe *foljore* ose thjesht fjali *foljore* :- *Jashtë bënte fresk.*);
- u thotë të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 34 fjalitë : *Xhaxhi Mitrushi ishte një plak rreth tetëdhjetë vjeç. Flokëbardhë e mjekërbardhë. Si pleqtë e përrallave.*
- bën pyetjet: *Sa fjali janë? Sa gjymtyrë kryesore ka fjalia e parë? Çfarë fjalie është një apo dykryegjymtyrëshe? Sa gjymtyrë kryesore ka fjalia e dytë? Me se është e shprehur? Çfarë fjalie është? Po fjalia e tretë sa gjymtyrë kryesore ka? Me se është shprehur? Çfarë fjalie është?*
- nxjerrin përfundimin që fjalitë njëkryegjymtyrëshe emërore përbëhen vetëm nga një grup emëror: *Flokëbardhë e mjekërbardhë. Si pleqtë e përrallave.*

Ora e dytë

Synimi: të përforcojnë njohuritë e fituara për fjalinë njëkryegjymtyrëshe emërore dhe t'i përdorin drejt ato.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u thotë të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 35 fjalitë: *Mbrëmje dhjetori. Qetësi. S'dëgjohej asgjë përreth. Ja lulishtja, Ja shkolla. Ja shtëpia jonë.*
- bën pyetjet: *Sa fjali ka? Çfarë fjalish janë? Çfarë tregojnë fjalitë emërore : Mbrëmje dhjetori. Qetësi.? Çfarë fjalish emërore janë ato?;*

- bën pyetjen: *Çfarë tregojnë fjalitë emërore: Ja lulishtja, Ja shkolla. Ja shtëpia jonë.? Çfarë fjalish emërore janë ato?;*
- nxjerrin përfundimin që disa fjali emërore përdoren kur duam të përshkruajmë dukuri të natyrës dhe ata quhen fjali emërore *përshkruese*; që disa fjali emërore përdoren për të treguar diçka që është e pranishme dhe ata quhen fjali emërore *treguese*.
- u kërkon të lexojnë poezinë “*Fshati im*” të A. Z. Çajupit dhe u bën pyetjen: *Me çfarë fjalish është ndërtuar vjersha?*
- nxjerrin përfundimin që fjalitë emërore janë karakteristike për gjuhën e shkruar e sidomos për stilin e letërsisë artistike;
- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1- 5 në Fletoren e punës, fq. 23, 24 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Fjalitë njëkryegjymtyrëshe foljore

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të dallojnë fjalitë e thjeshta njëkryegjymtyrëshe foljore dhe t'i përdorin drejt ato në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 36 tekstin “*Gjahu i malësorëve*”;
- bën pyetjet: *Sa gjymtyrë kryesore kanë fjalitë me shkronja blu? Me se është shprehur gjymtyra kryesore në këto fjali? Çfarë fjalish njëkryegjymtyrëshe janë ato?*;
- nxjerrin përfundimin që fjalitë: - *Sot ka pesëmbëdhjetë ditë.* - *Ka bërë mot i mirë.* - *A dalim nesër për gjah?* - *Dalim....* etj. që kanë vetëm grupin foljor (folje ose folje + diçka tjetër), janë fjali njëkryegjymtyrëshe foljore;
- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 36 tri grupet e fjalive njëkryegjymtyrëshe foljore që vijojnë;
- bën pyetjet: *Në çfarë vete është folja në fjalitë foljore të grupit A? Kush e kryen veprimin në këto fjali? Nga se bëhet i qartë vepruesi në këto fjali? Çfarë fjalish foljore janë këto fjali?*
- nxjerrin përfundimin që fjalitë njëkryegjymtyrëshe foljore të grupit A që e kanë foljen në vetën e parë ose në vetën e dytë, njëjës ose shumës, janë fjali foljore *vetore*, që në fjalitë foljore *vetore*, personi që e kryen veprimin bëhet i qartë nga mbaresat e foljes dhe situata; bën pyetjet: *Në çfarë vete është folja në fjalitë foljore të grupit B? Kush e kryen veprimin në këto fjali? Çfarë fjalish foljore janë këto fjali?*;
- nxjerrin përfundimin që edhe fjalitë foljore të grupit B që e kanë foljen në vetën e tretë shumës janë fjali foljore *vetore* dhe që në këto fjali, ata që e kryejnë veprimin janë të papërcaktuar;
- bën pyetjet: *Kush e kryen veprimin në fjalitë foljore të grupit C? Çfarë fjalish foljore janë këto fjali?*
- nxjerrin përfundimin që edhe fjalitë e grupit C janë fjali foljore *vetore*. Në këto fjali folja tregon njerëz në përgjithësi, duke përfshirë edhe folësin dhe ata që e kryejnë veprimin janë të papërcaktuar;

Ora e dytë

Synimi: të zgjerojnë e përforcojnë njohuritë e fituara për fjalinë njëkryegjymtyrëshe foljore dhe t'i përdorin drejt ato.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u thotë të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 37 fjalitë njëkryegjymtyrëshe *Po erret, I ndodhi keq* etj.;
- bën pyetjet: *Në çfarë vete është folja në këto fjali? Kush e kryen veprimin në këto fjali? Çfarë fjalish foljore janë këto fjali?*;
- nxjerrin përfundimin që fjalitë njëkryegjymtyrëshe foljore që ndërtohen me folje ose shprehje foljore pavetore janë fjali foljore *pavetore*. Në këto fjali ai që e kryen veprimin nuk është as i përcaktuar, as i shprehur;
- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1- 5 në *Fletoren e punës*, fq. 25, 26 dhe t'i verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre .

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Kryefjala

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të dallojnë kryefjalën dhe ta përdorin drejt atë në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 38 tekstin “Ujku”;
- bën pyetjet: *Kush e ka shkruar këtë tekst? Çfarë bën autori në këtë tekst? Çfarë teksti është ky? Fjalitë me shkronja të zeza janë të thjeshta apo të përbëra? A janë një apo dykryegjymtyrëshe? Cilat janë dy gjymtyrët kryesore të fjalisë së parë? Çfarë është gjymtyra e parë tre ujqit e vegjël? Po gjymtyra e dytë po grindeshin me njeri-tjetrin? A është e mundur të hiqet grupi emëror tre ujqit e vegjël? Çfarë tregon ai? Çfarë funksioni kryen grupi emëror tre ujqit e vegjël?*
- nxjerrin përfundimin që emri, përemri (*Ata, Ai*) ose grupi emëror (*Tre ujqit, Ujku i madh*) që tregon atë për të cilin flasim, është kryefjalë e fjalisë, që kryefjala nuk mund të hiqet.
- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 39 fjalitë: *Ujku vazhdonte të rrinte i shtrirë... Tre ujqit po grindeshin me njëri-tjetrin. Ata po shqyenin trastën time.*
- bën pyetjet: *Çfarë pyetjeje i përgjigjet fjala ujku në fjalinë e parë? Çfarë është fjala ujku që i përgjigjet pyetjes kush? Çfarë pyetjeje i përgjigjet fjala tre ujqit në fjalinë e dytë? Çfarë është fjala tre ujqit në fjalinë e dytë? Po fjala ata në fjalinë e tretë çfarë pyetjeje i përgjigjet? Cilën fjalë të fjalisë së dytë zëvendëson fjala ata në fjalinë e tretë?*
- nxjerrin përfundimin që për të gjetur kryefjalën e një fjalie, bëjmë pyetjet *cili? kush?*, që, kur një grup emëror mund të zëvendësohet nga *ai (ata), ajo (ato)*, ai grup emëror është gjithmonë kryefjalë;
- u kërkon të lexojnë fjalitë: *Tre ujqit po grindeshin me njëri-tjetrin. Ujqit po grindeshin me njëri-tjetrin. Ata po shqyenin trastën time dhe po hanin bukën që më kishte mbetur.*
- bën pyetjet: *Çfarë fjalish janë fjalitë e mësipërme? Cilat janë kryefjalët e këtyre fjalive? Me se është shprehur kryefjala në fjalinë e parë? Po në fjalinë e dytë dhe të tretë? Çfarë vendi zë kryefjala në fjalitë dëftore?*
- nxjerrin përfundimin që kryefjalë e fjalisë zakonisht është një grup emëror i shprehur me një emër plus përcaktor (*Tre ujqit e vegjël*), me një emër (*Ujqit*), me një përemër (*Ata*), që në fjalinë dëftore kryefjala zakonisht vendoset përpara foljes;

Ora e dytë

Synimi: të përforcojnë njohuritë e fituara për kryefjalën dhe ta përdorin drejt atë.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u thotë të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 39, fjalitë njëkryegjymtyrëshe *Portokajtë, limonët dhe mandarinat i pjekin frutat në dimër? Shko në shtëpi. Ai i ndau dhe i ftoi të bijtë të hanë të qetë;*
- u kërkon të gjejnë foljet dhe kryefjalët e këtyre fjalive dhe bën pyetjet: *Sa kryefjalë ka fjalia e parë? A ka kryefjalë fjalia e dytë? Pse nuk ka kryefjalë fjalia e dytë? Kryefjalë e cilës folje është përemri ai në fjalinë e tretë?*
- nxjerrin përfundimin që një fjali mund të ketë disa kryefjalë që i përkasin të njëjtës folje, që

foljet në mënyrën urdhërore përdoren pa kryefjalë dhe që kryefjala e dy foljeve të bashkërenditura nuk përsëritet;

- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-5 në *Fletoren e punës*, fq. 27, 28 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre .

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Kallëzuesi

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të dallojnë kallëzuesin dhe ta përdorin drejt atë në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 41 fjalitë: *Tre ujqit po grindeshin me njëritjetrin. Ujkonja ishte e shkujdesur.*;
- bën pyetjet: *Me cilat fjalë lidhet dhe çfarë tregon folja me shkronja të zeza në fjalinë e parë? Çfarë pyetjeje i përgjigjet? Çfarë funksioni kryen në fjali? A mund të hiqet? Me se është shprehur kallëzuesi në fjalinë e dytë? Çfarë kallëzuesi është? A mund të hiqet?*
- nxjerrin përfundimin që foljet lidhen drejtpërsëdrejti me kryefjalën dhe tregojnë ç'bën, ç'pëson ose gjendjen e kryefjalës, kryejnë, pra, funksionin e kallëzuesit në fjali. Për të gjetur kallëzuesin e një fjalie bëjmë pyetjet : *ç'bën? ç'është? si është?* Kallëzuesi nuk mund të hiqet. Kallëzuesi i shprehur me folje quhet kallëzues *foljor* (*grindeshin*). Kallëzuesi i shprehur me foljen ndihmëse *jam* dhe një emër, përemër ose numëror quhet kallëzues emëror (*ishte e shkujdesur*).
- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 41 fjalitë: *Tre ujqit po grindeshin me njëritjetrin. Ata po shqyenin trastën time. Ai shikonte me zemërim të vegjlit dhe t'ëmën e tyre. Zënkat ndërmjet tre të vegjëleve u trashën. Ata filluan të kafshonin njëritjetrin.. Zhurma nuk mund të durohej nga babai nevrik. Ujku i madh, i ati, vazhdonte të rrinte i shtrirë. Por, më shumë duhet t'i vinte inat për ujkonjën. Ujku i madh, i ati, vazhdonte të rrinte i shtrirë.*;
- bën pyetjet: *Çfarë janë fjalët me shkronja të zeza në fjalitë e mësipërme? Çfarë funksioni kryejnë në fjali? Me se shprehet kallëzuesi foljor në grupin e parë të fjalive? Çfarë kallëzuesi foljor është? Me se shprehet kallëzuesi foljor në grupin e dytë të fjalive? Cila folje mbart kuptimin kryesor? Çfarë kallëzuesi foljor është?*
- nxjerrin përfundimin që kallëzuesi mund të shprehet me një ose dy folje, që kallëzuesi i shprehur me *një folje* në kohët e thjeshta ose të përbëra, është kallëzues *foljor i thjeshtë* dhe që kallëzuesi i shprehur me *dy folje*, nga të cilat njëra mbart kuptimin kryesor, është kallëzues i përbërë;
- u kërkon të lexojnë në *Librin nxënësit*, fq. 41 tekstin në vijim “*Për mua ajo ishte një ditë e frikshme...*”;
- bën pyetjet: *Çfarë janë fjalët me shkronja të zeza? Çfarë pyetjeje i përgjigjen? Çfarë funksioni kryejnë? Me se janë shprehur kallëzuesit emërorë me shkronja të zeza?*
- nxjerrin përfundimin që kallëzuesi emëror shprehet nga folja *jam* plus një *emër*, një *mbiemër*, një *përemër*, një *numëror* ose një *grup emëror*;
- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-3 në *Fletoren e punës*, fq. 29, 30 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre .

Ora e dytë

Synimi: të përforcojnë njohuritë e fituara për kallëzuesin dhe ta përdorin drejt atë.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u thotë të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 40 fjalitë *Tre ujqit e vegjël po grindeshin me njëri-tjetrin. Ata po shqyenin trastën time. Ujku i madh, i ati, vazhdonte të rrinte i shtrirë. Ai shikonte me zemërim të vegjlit dhe t'ëmën e tyre.*;
- u kërkon të gjejnë kryefjalët dhe kallëzuesit e këtyre fjalive dhe bën pyetjet: *Në çfarë numri dhe vete janë kryefjalët në dy fjalitë e para? Në çfarë numri dhe vete janë kallëzuesit në këto fjali? Në çfarë numri dhe vete janë kryefjalët në dy fjalitë e dyta? Në çfarë numri dhe vete janë kallëzuesit në këto fjali?*
- nxjerrin përfundimin që kallëzuesi përshtatet me kryefjalën në numër dhe vetë; u kërkon të shikojnë skemat dhe të lexojnë fjalitë: *Zana këndon, Zana këndon e kërcen bukur*;
- u kërkon të përcaktojnë llojet e kallëzuesit foljor duke u nisur nga tabelat e mësipërme.
- rikonfirmojnë që kallëzuesi foljor mund të jetë *i thjeshtë* dhe *i përbërë* dhe që kallëzuesi emëror mund të jetë *i ndërtuar nga folja jam plus një emër, një mbiemër, një përemër, një numëror dhe një grup emëror*.
- bëjnë ushtrimet 4-6 në *Fletoren e punës*, fq. 30, 31 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 15

Lajmi dhe njoftimi

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të lexojnë dhe kuptojnë tekste publicistike, të dallojnë lajmin dhe njoftimin dhe pyetjet të cilave duhet t'u përgjigjen.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon nxënësve të flasin për format e ndryshme të teksteve që kanë lexuar nëpër gazeta ose të atyre që kanë dëgjuar në radio dhe televizion; i pyet për dallimet që kanë ato me shkrimet letrare artistike që kanë lexuar;
- nxjerrin përfundimin që format e të shprehurit në gazetë janë *lajmi, njoftimi, intervista, reportazhi* etj.
- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 46 tekstin “*Gratë kundër dhunës në familje*”;
- bën pyetjet: *Për çfarë flitet në këtë tekst? Cili është qëllimi i këtij teksti? Kush e ka organizuar aktivitetin? Çfarë aktiviteti ka organizuar? Ku e ka organizuar? Kur e ka organizuar? Përse e ka organizuar? Ngjarja është e vërtetë apo jo? Teksti është artistik apo jo? Teksti është publicistik apo jo? Teksti është tregim, përshkrim, lajm?*
- nxjerrin përfundimin që lajmi është forma themelore e shkrimit në gazetë me të cilin jepen vetëm të dhënat dhe faktet më të rëndësishme rreth një personaliteti, ngjarje apo fenomeni, madje edhe ato shumë shkurt. Lajmi duhet t'u përgjigjet pyetjeve: *kush?, çfarë?, kur?, ku? ose si? përse?*
- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 46, 47 tri tekstet e marra nga shtypi;
- bën pyetjet: *Për çfarë flitet në këto shkrime? Çfarë janë këto shkrime? Si quhen këto lajme? Pse këto lajme quhen flesh? Çfarë do të thotë fjala angleze flesh? Cilat janë karakteristikat e lajmit të shkurtër (flesh): Del në pah më shumë aktualiteti? Ka të dhëna më të plota se lajmi? Përdoret çdo ditë? Përdoret në situata të veçanta kur ndodh diçka shumë e rëndësishme që meriton të shpallet sa më parë?*
- nxjerrin përfundimin që lajmi i shkurtër (anglisht *flesh*, shqip *shkurt*) është ai që jepet për një ngjarje të rëndësishme e cila sapo është marrë vesh dhe për të cilën s'ka akoma të dhëna të hollësishme (*ngjarje e papritur, ndeshje me makinë, vdekja e një personi të rëndësishëm, atentat* etj). Lajmi i shkurtër nuk u përgjigjet pyetjeve: *kush? çfarë? kur? ku? ose si? përse?*;
- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-4 në *Fletoren e punës*, fq. 32 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre.

Ora e dytë

Synimi: të njohin veçoritë e njoftimit dhe të dinë ta dallojnë nga lajmi dhe lajmi i shkurtër.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u thotë të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 47 fjalitë “*Ka përfunduar me sukses turneu i Ansambllit shqiptar në Malin e Zi*”;
- bën pyetjet: *Për çfarë flitet në këtë tekst? Në cilat pjesë të këtij teksti gjenden përgjigjet e pyetjeve: kush? çfarë? ku? kur? si? përse?*
- u kërkon të lexojnë edhe një herë tekstin “*Gratë kundër dhunës në familje*”;
- bën pyetjen: *Çfarë dallimesh vini re ndërmjet tij dhe tekstit “Ka përfunduar me sukses turneu i Ansambllit shqiptar në Malin e Zi.”*

- nxjerrin përfundimin që ky tekst është një njoftim, që njoftimi, përveç të dhënave dhe fakteve të rëndësishme, jep edhe rrjedhën e ngjarjeve, pra fillimin, zhvillimin dhe përfundimin e tyre. Ashtu si lajmi edhe njoftimi u përgjigjet pyetjeve: *kush? çfarë? kur? ku? ose si? përse?*. Njoftimi bëhet gjatë kohës së ngjarjes ose menjëherë pas saj;
- bëjnë ushtrimet 5-6 në *Fletoren e punës*, fq. 32, 33 dhe verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Përcaktori

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të dallojnë përcaktorin dhe ta përdorin drejt atë në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 48 tekstin “*Shokët le të shfaqin mendimet e tyre*”;
- bën pyetjet: *Për çfarë flitet në këtë tekst? Sa fjali ka në këtë tekst? Çfarë fjalish janë, të thjeshta apo të përbëra? Fjalitë e thjeshta janë një apo dykryegjymtyrëshe?*
- u kërkon të veçojnë fjalitë dykryegjymtyrëshe, të cilat mund t’i shkruajë në tabelë duke shënuar me shkronja të kuqe kryefjalët, me shkronja blu kallëzuesit dhe me shkronja jeshile pjesët plotësuese;
- bën pyetjet: *Çfarë janë fjalët me ngjyrë të kuqe? Çfarë janë fjalët me ngjyrë blu? Çfarë gjymtyrësh janë kryefjala e kallëzuesi? Me cilat fjalë lidhen fjalët me shkronja jeshile? Çfarë tregojnë fjalët me shkronja jeshile? Çfarë gjymtyrësh janë fjalët me shkronja jeshile?*
- nxjerrin përfundimin që kryefjala dhe kallëzuesi janë gjymtyrë kryesore të fjalisë dhe që përveç tyre fjalia ka edhe gjymtyrë të dyta që lidhen me gjymtyrët kryesore;
- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 48 fjalitë: *Vjersha e Bonës është e bukur. Tregimi i Fatmirit është i mirë. Puna e tij është për t’u lavdëruar. Vjersha e Norës duhet shkurtuar.*;
- bën pyetjet: *Çfarë janë grupet e fjalëve me shkronja të zeza? Cilët janë emrat bërthamë të grupeve emërore me shkronja të zeza? Çfarë janë fjalët e Bonës, i Fatmirit, e tij, e Norës që shoqërojnë emrat bërthamë? Çfarë tregojnë emrat dhe përemrat e Bonës, i Fatmirit, e tij, e Norës që shoqërojnë emrat? Çfarë funksioni kryejnë emrat e Bonës, i Fatmirit, e tij, e Norës që shoqërojnë emrat?;*
- nxjerrin përfundimin që fjalët që përcaktojnë ose saktësojnë emrat bërthamë të një grupi emëror janë përcaktorë;
- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 49 tabelën që shënon se me se shprehen përcaktorët;
- bën pyetjet: *Me se shprehen përcaktorët? Nga se varen përcaktorët?*
- nxjerrin përfundimin që përcaktorët mund të jenë *emra, mbiemra, përemra, numërorë, ndajfolje dhe forma të pashtjelluara të foljeve* dhe varen nga një emër po edhe nga një përemër, mbiemër, numëror dhe ndajfolje.
- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-3 në *Fletoren e punës*, fq. 34 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre .

Ora e dytë

Synimi: të përforcojnë njohuritë e fituara për përcaktorin dhe ta përdorin drejt atë.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u thotë të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 49 fjalitë: *Abdylbeu kishte dy sy të mëdhenj e të thellë. Flokët e ndritshëm të vajzës, të pleksur si një kurorë e argjendtë, i jepnin fytyrës së saj një pamje të mrekullueshme. Futbollistët, të gëzuar nga fitorja, përqaфонin njëri-tjetrin.*;
- bën pyetjet: *Me se janë shprehur përcaktorët me shkronja rozë dhe blu? Çfarë dallimi vini re ndërmjet përcaktorëve me shkronja rozë dhe atyre me shkronja blu? Çfarë përcaktorësh*

janë ato me shkronja rozë? Çfarë përcaktorësh janë ata me shkronja blu? Çfarë shenje pikësimi vihet para përcaktorit të veçuar?

- nxjerrin përfundimin që përcaktori i shprehur me mbiemër mund të jetë: përcaktor *i paveçuar* që vjen menjëherë pas emrit që përcakton dhe përcaktor *i veçuar* nga emri që përcakton me anë të një pauze (pushimi) dhe që në të shkruar, përcaktori i veçuar ndahet gjithmonë me presje;
- u kërkon të bëjnë ushtrimet 4-6 në *Fletoren e punës*, fq. 35 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Ndajshtimi

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të dallojnë ndajshkrimin dhe ta përdorin drejt atë në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- pyet nxënësit se çfarë dinë për metronë dhe, nëse kanë pasur rast të hipin në metro, të tregojnë përshtypjet e tyre për të;
- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 50 tekstin “*Violinisti i njohur luan në metro*”;
- bën pyetjet: *Nga është marrë ky tekst? Ngjarja është e vërtetë apo jo? Teksti është artistik apo jo? Teksti është publicistik apo jo? Çfarë është ky tekst?* dhe u kërkon ta argumentojnë;
- u kërkon të gjejnë emrin bërthamë të grupeve emërore me shkronja të zeza dhe bën pyetjet: *Përse shërbejnë grupet e fjalëve: violinisti me famë botërore, Uashington Post, fitues i dy çmimeve ndërkombëtare? Çfarë janë grupet e fjalëve: violinisti me famë botërore, Uashington Post, fitues i dy çmimeve ndërkombëtare?;*
- nxjerrin përfundimin që ndajshtimi është një lloj përcaktori që vihet pranë një emri tjetër bërthamë dhe emërton të njëjtën qenie ose të njëjtin send a dukuri si edhe emri-bërthamë;
- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-2 në *Fletoren e punës*, fq. 36 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre.

Ora e dytë

Synimi: të përforcojnë njohuritë e fituara për ndajshkrimin dhe ta përdorin drejt atë.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë fjalitë: *Joshua Bell, violinisti me famë botërore, ka luajtur ne metronë e Uashingtonit dhe ndonëse shumë i njohur, muzika e tij është injoruar pothuajse nga të gjithë kalimtarët. Në fakt e gjithë kjo histori ka qenë një eksperiment që ka dashur të bëjë gazeta Uashington Post dhe violinisti i famshëm ka qenë shumë i gatshëm për të marrë pjesë në të. Joshua Bell, fitues i dy çmimeve ndërkombëtare, që luante pjesë nga Bah, Shubert e Masenet nuk ka hezitur të përdorë një violinë të vitit 1713, që kushton rreth tre milionë dollarë;*
- bën pyetjet: *Çfarë dallimi vini re ndërmjet ndajshtimeve me shkronja blu dhe atyre me shkronja rozë? Çfarë ndajshtimesh janë ata me shkronja blu? Me se janë shprehur? Çfarë ndajshtimi është ai me shkronja rozë? Me se është shprehur? Si dallohen ndajshtimi i paveçuar dhe i veçuar në të folur dhe në të shkruar?*
- nxjerrin përfundimin që ndajshtimi është dy llojesh, *i paveçuar* dhe *i veçuar*. Ndajshtimi *i paveçuar*, zakonisht, është një emër i pashquar në rasën emërore ose një grup emëror që vihet pranë një emri, para ose pas tij. Ai nuk ndahet nga emri bërthamë, as me pushim në të folur, as me presje në të shkruar. Ndajshtimi *i veçuar* është një emër ose një grup emëror që vihet pas emrit-bërthamë ose pas një përemri për ta sqaruar ose për ta saktësuar më tej kuptimin e tij. Në të folur, ndahet nga emri që përcakton me një *pushim* të shkurtër, kurse në të shkruar, me *presje*.
- u kërkon të bëjnë ushtrimin 3 në *Fletoren e punës*, fq. 36 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Kundrinori

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të dallojnë kundrinorin dhe ta përdorin drejt atë në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- pyet nxënësit se çfarë dinë për Gjergj Elez Alinë dhe, nëse kanë pasur rast të lexojnë diçka për të, të tregojnë;
- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 52 tekstin “Gjergj Elez Alia”;
- bën pyetjet: *Kush e ka shkruar këtë tekst? Përse flitet në këtë tekst? Çfarë janë fjalët me shkronja blu? Në çfarë rase janë fjalët me shkronja blu? Me cilat fjalë lidhen emrat, përemrat ose grupet emërore me shkronja blu? Çfarë tregojnë ata? Me çfarë pyetjeje gjenden ata? A mund të hiqen ata pa prishur kuptimin e fjalisë? Çfarë funksioni kryejnë ata në fjali? Me se shprehet kundrinori i drejtë në këto fjali?*
- nxjerrin përfundimin që grupet e fjalëve me shkronja blu janë emra, përemra ose grupe emërore në rasën kallëzore, se ato lidhen me foljet dhe u përgjigjen pyetjeve *kë?, ç?, çfarë?, cilin?, cilën?, cilët?, cilat?* drejtuar foljes, pra, *kundrinorë të drejtë*, që kundrinori i drejtë tregon objektin (personin ose sendin), mbi të cilin bie drejtpërdrejt veprimi i shprehur nga folja dhe nuk mund të hiqet, që kundrinori i drejtë është gjymtyrë e dytë e fjalisë e domosdoshme në fjali;
- u kërkon të bëjnë ushtrimin 1 në *Fletoren e punës*, fq. 37 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tij.

Ora e dytë

Synimi: të aftësohen të dallojnë kundrinorin e zhdrejtë me dhe pa parafjalë dhe ta përdorin drejt atë në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë pjesën e shkëputur nga teksti “Gjergj Elez Alia” :
Vite e vite ai i kish dalë zot truallit të parëve; ia kish mbrojtur nderin. Kish luftuar me topuz e shpatë kundër armiqve të derdhur këtej nga deti e nga toka për të shkelur vendin, për ta dhunuar e zhveshur.
Nuk e kish harruar vetëm e motra, që i rrinte ditë e natë mbi krye: i lante plagët me ujët e gurrës nëntë vjeçe, ia shpëlante me lotët e syve të saj, i terte gjakun me flokët e ballit; shtatin ia lidhte me shamitë e nënës, ia hijeshonte me petkat e moçme të tatës; armët e brezit ia rendiste mbi krye.
- bën pyetjet: *Çfarë janë fjalët me shkronja rozë? Në çfarë rase janë ato? Nga cilat fjalë varen fjalët me shkronja rozë? Çfarë tregojnë ata? Me çfarë pyetjeje gjenden ata? A mund të hiqen ata pa prishur kuptimin e fjalisë? Çfarë funksioni kryejnë ata në fjali? Çfarë janë fjalët me shkronja portokalli? Ku dallohen nga fjalët me shkronja rozë? Nga cilat fjalë varen fjalët me shkronja portokalli? Çfarë tregojnë ata? Me çfarë pyetjeje gjenden ata? A mund të hiqen ata pa prishur kuptimin e fjalisë? Çfarë funksioni kryejnë ata në fjali?*
- nxjerrin përfundimin që grupet e fjalëve me ngjyrë rozë dhe portokalli janë kundrinorë të zhdrejtë, që kundrinori i zhdrejtë mund të jetë *me* dhe *pa parafjalë*, që kundrinori i zhdrejtë

pa parafjalë është një *emër*, një *përemër* ose *grup emëror* (një emër dhe një përcaktor) në rasën *dhanore pa parafjalë* që tregon sende ose qenie mbi të cilat bie veprimi i shprehur nga folja, që kundrinori i zhdrejtë pa parafjalë përdoret gjithmonë me trajtë të shkurtër të përemrit vetor, që u përgjigjet pyetjeve *kujt?*, *cilit?*, *cilës?*, *cilëve?*, *cilave?* drejtuar foljes.

- vijohet me përfundimet të tjera për kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë, që kundrinori *i zhdrejtë me parafjalë* është një emër, një përemër ose një grup emëror (emër dhe një përcaktor) në rasën *emërore*, *kallëzore* ose *rrjedhore*, *i paraprirë gjithmonë nga një parafjalë*, që kundrinori i zhdrejtë me parafjalë ngjan shumë për nga ndërtimi me rrethatorët, po për të gjetur kundrinorin e zhdrejtë me parafjalë përdoret pyetja me përemër e paraprirë nga një parafjalë, kurse për rrethatorët përdoret pyetja me ndajfolje, që kundrinori i zhdrejtë me parafjalë mund të varet nga një *folje*, nga një *mbiemër* dhe nga *grupi emëror*;
- u kërkon të bëjnë ushtrimet 2-5 në *Fletoren e punës*, fq. 37, 38 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre.

Vërejtje: mësues-i/ja, në rast se e sheh të nevojshme, mund të përdorë edhe një orë tjetër mësimi për këtë temë.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Përcaktori kallëzuesor

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të dallojnë përcaktorët kallëzuesorë dhe t'i përdorin drejt ata në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:


- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 55 tekstin “*Manushaqe bukuroshe*”;
- bën pyetjet: *Kush e ka shkruar këtë tekst? Për çfarë flitet në këtë tekst? Çfarë teksti është ky? Çfarë janë fjalët me ngjyrë blu? Me cilat fjalë lidhen emrat dhe mbiemrat me ngjyrë blu? Çfarë gjymtyre e fjalisë janë fjalët me të cilat lidhen emrat dhe mbiemrat me ngjyrë blu? Çfarë tregojnë emrat dhe mbiemrat me ngjyrë blu? Çfarë funksioni kryejnë në fjali emrat dhe mbiemrat me shkronja blu? Çfarë janë fjalët me shkronja blu?*
- nxjerrin përfundimet që emri *halë* dhe mbiemrat *e mpitë, e qetë, trime* lidhen edhe me kryefjalën dhe me foljen kallëzues, që ato tregojnë gjendje ose cilësi të sendeve që shënohen nga kryefjalët *ti* (e nënkuptuar) dhe *fletët* dhe që për pasojë janë përcaktorë të kryefjalës.
- bën pyetjet : *Me cilat fjalë lidhen emrat dhe mbiemrat me shkronja rozë? Çfarë tregojnë emrat dhe mbiemrat me shkronja rozë? Çfarë funksioni kryejnë në fjali emrat dhe mbiemrat me shkronja rozë?*
- nxjerrin përfundimet që mbiemrat *të mjerë, të gJORë, të thatë* lidhen edhe me kundrinorin e drejtë dhe me foljen kallëzues, që ata tregojnë gjendje ose cilësi të sendeve që shënohen nga kundrinori i drejtë (*ty të la të mjerë, të gJORë; ty të shoh të thatë*) dhe që për pasojë mbiemrat *të mjerë, të gJORë, të thatë* janë përcaktorë të kundrinorit të drejtë.
- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-2 në *Fletoren e punës*, fq. 39 dhe të verifikojnë, përmes diskutimit, realizimin e tij.

Ora e dytë

Synimi: të aftësohen të dallojnë përcaktorët kallëzuesorë dhe t'i përdorin drejt ata në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë dhe analizojnë skemat në vazhdim;



- bën pyetjet: *Me cilat gjymtyrë të fjalisë lidhen fjalët me ngjyrë blu në fjalinë e parë dhe të dytë? Çfarë tregojnë fjalët me ngjyrë blu në secilën nga këto dy fjali? Çfarë pyetjeje i përgjigjen fjalët me ngjyrë blu në secilën fjali? Çfarë janë fjalët me ngjyrë blu në fjalinë e parë dhe të dytë?*
- përforcojnë konkluzionin që përcaktori kallëzuesor ka lidhje të dyfishtë me foljen kallëzues dhe me emrin ose përemrin kryefjalë ose kundrinor që, kur lidhet me kryefjalën, i përgjigjet

pyetjes *si?* dhe quhet përcaktor kallëzuesor *i kryefjalës* dhe, kur lidhet me kundrinorin e drejtë, i përgjigjet pyetjes *çfarë?* dhe quhet përcaktor kallëzuesor *i kundrinorit*;

- u kërkon të bëjnë ushtrimin 3 në *Fletoren e punës*, fq. 39 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre.

Ora e tretë

Synimi: të aftësohen të dallojnë përcaktorët kallëzuesorë dhe t'i përdorin drejt ata në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë fjalitë: *Drita u emërua drejtoreshë. Gazmendi mbahej për trim. Vjollca është bërë si e shtëpisë. Të gjithë rrinin si të ngirë. Vajza ndjehej e lumtur. Gjuha është shenjë e kombësisë;*
- bën pyetjet: *Çfarë janë fjalët me shkronja të zeza? Me cilat fjalë lidhen? Çfarë funksioni kryejnë në fjali? Me se janë shprehur përcaktorët kallëzuesorë të kryefjalës?*
- nxjerrin përfundimin që përcaktori kallëzuesor i kryefjalës mund të jetë, një *emër* me ose pa parafjalë, një emër në *gjinore*, një emër i paraprirë nga *si*, një *mbiemër*, një mbiemër i paraprirë nga *si* ose një *grup emëror* (emër plus përcaktor);
- u kërkon të lexojnë fjalitë: *E mori sapunin për djathë. Mediun e kishin si djalë. Flamurin ta mbajmë të pastër. Gonin e trajtonin si të rritur. Trupin e kishte tërë gjak. Luftën kundër korrupsionit e quanim detyrën tonë.*
- bën pyetjet: *Çfarë janë fjalët me shkronja të zeza? Me cilat fjalë lidhen? Çfarë funksioni kryejnë në fjali? Me se janë shprehur përcaktorët kallëzuesorë të kundrinorit të drejtë?;*
- nxjerrin përfundimin që përcaktori kallëzuesor i kundrinorit të drejtë mund të jetë një *emër* me ose pa parafjalë, një emër i paraprirë nga *si*, një *mbiemër*, një mbiemër i paraprirë nga *si* ose një *grup emëror* (emër plus përcaktor);
- u kërkon të bëjnë ushtrimet 4- 6 në *Fletoren e punës*, fq. 39, 40 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 20

Përshkrimi

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të kuptojnë e analizojnë tekste përshkruese dhe të njohin veçoritë e ndërtimit e funksionimit të tyre.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- duke iu referuar njohurive të fituara në klasën e gjashtë bën pyetjet: *Cilat janë format e shprehjes? Cilat janë veçoritë e përshkrimit?*;
- nxjerrin përfundimin që format kryesore të shprehjes janë *tregimi* dhe *përshkrimi*, që të përshkruash do të thotë të paraqesësh *pamjen* ose *típaret* e dikujt a të diçkaje, *rrethanat* e zhvillimit të një ngjarjeje etj, që për përshkrimin nuk kanë rëndësi koha e ngjarjes (mund të përshkruhet, p.sh., jeta në Romën e Vjetër apo në Greqinë antike) dhe rrjedha e tyre etj.;
- u thotë të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 60 tekstin “*Mjerimi njerëzor*”
- shpjegon fjalët e vështira;
- bën pyetjet: *Kush e ka shkruar këtë tekst? A tregohen ngjarje në këtë tekst? Çfarë bën autori në këtë tekst? U kërkon të gjejnë dhe të komentojnë fragmentet që përshkruajnë plakën. Bën pyetjet : Ku dallohen ato nga fragmenti i fundit që është një thirrje që u drejtohet të rinjve? Në çfarë kohe janë foljet me shkronja të zeza në pjesët përshkruese të tekstit? Po në paragrafin e fundit në çfarë kohe janë foljet? Pse ndryshon koha e foljeve në paragrafin e fundit të këtij teksti? Çfarë pjese të ligjëratës përdor autori për të përshkruar plakën? Çfarë është ky tekst: një lajm, një përshkrim, një tregim?* dhe u kërkon ta argumentojnë mendimin e tyre;
- nxjerrin përfundimin që të përshkruash do të thotë të paraqesësh me fjalë një objekt, një peizazh, një skenë të realitetit që dëgjuesi ose lexuesi të mund ta përfytyrojë, që në një përshkrim foljet zakonisht janë në kohën e pakryer ose në të tashmen, që përshkrimi karakterizohet nga përdorimi i mbiemrave dhe që mbiemrat lejojnë të karakterizohen elementet e përshkuara;

Ora e dytë

Synimi: të aftësohen të kuptojnë e analizojnë tekste përshkruese dhe të njohin veçoritë e ndërtimit e funksionimit të tyre.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u thotë të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 61 tekstin “*Bukuria që vret*”
- shpjegon fjalët e vështira;
- bën pyetjet: *Kush e ka shkruar këtë tekst? A është teksti në gjuhën letrare? U kërkon ta argumentojnë përgjigjen me të dhëna nga teksti. Vijon me pyetjet : Çfarë paraqet autori në këtë tekst? Si i kuptoni fjalët e tij “Dhe të vret kjo bukuri e bardhë. Vret shpirtin e malsorit...”? A ka personazhe në këtë tekst? A tregohet në këtë tekst një ngjarje që ka hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen? Çfarë bën autori në këtë tekst? Në çfarë kohe janë foljet me shkronja të zeza në këtë tekst? Çfarë është ky tekst: një lajmërim, një tregim, një përshkrim?*
- nxjerrin përfundimin që teksti „*Bukuria që vret*“ është shkruar në gegërishten letrare, që në këtë tekst përshkruhet një skenë nga jeta në kohë dimri, që ai është një përshkrim dhe që koha kryesore e foljeve është *e tashmja*.

- u kërkon të lexojnë fjalët dhe shprehjet që mund të përdoren për të përshkruar gjëra që mund të shihen, të dëgjojnë, që preken, dhe gjëra që kanë erë ose shije dhe t'i përdorin në një tekst të shkurtër të krijuar prej tyre;
- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1- 5 në *Fletoren e punës*, fq. 41, 42, 43.

Vërejtje: mësues-i/ja, nëse e sheh të nevojshme, mund të përdorë edhe një orë tjetër mësimi për këtë temë.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Rrethanorët

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të dallojnë rrethanorët dhe t'i përdorin drejt ata në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 63 tekstin “Luftëtari kombëtar”;
- bën pyetjet: *Kush e ka shkruar këtë tekst? Për kë flitet në këtë tekst? Çfarë ishte Nexhip Bënja? Si ishte ai? U kërkon të lexojnë tekstin, duke hequr grupet e fjalëve me ngjyrë blu. Bën pyetjen: Teksti që mbetet, a është i saktë dhe i kuptueshëm? U kërkon të zhvendosin grupet e fjalëve me ngjyrë blu. Bën pyetjet: Cili nga ata zhvendoset më lehtë? Pse? Me cilat fjalë lidhen fjalët me ngjyrë blu? Çfarë tregojnë fjalët me ngjyrë blu? Çfarë janë grupet e fjalëve me ngjyrë blu?*
- nxjerrin përfundimin rrethanorët janë gjymtyrë të dyta të fjalisë që tregojnë rrethana të kryerjes së veprimit (*vend, kohë, sasi, qëllim, mënyrë, shkak*). Rrethanorët lidhen me foljen dhe janë pjesë përbërëse e grupit foljor. Ata mund të zhvendosen dhe të hiqen pa prishur kuptimin e fjalisë.
- U kërkon të vështrojnë tabelën dhe të lexojnë fjalitë me rrethanorë vendi, kohe, sasi, qëllimi, mënyrë, shkak;
- bën pyetjet: *Sa lloj rrethanorësh ka në gjuhën shqipe? Me se mund të shprehen rrethanorët? Çfarë vendi zënë në fjali?*
- nxjerrin përfundimet që rrethanorët janë: *vendi, kohe, sasi, qëllimi, mënyrë dhe shkak*, që rrethanorët mund të shprehen me një *ndajfolje* ose *shprehje ndajfoljore*, me një *emër* ose me një *grup emëror* me ose pa parafjalë, dhe me një *formë të pashtjelluar foljore*, që shumica e rrethanorëve qëndron *pas* foljes dhe që rrethanorët *e vendit* dhe *të kohës* zakonisht qëndrojnë *para* foljes, por mund të qëndrojnë edhe *pas* saj.

Ora e dytë

Synimi: të përforcojnë njohuritë e fituara për rrethanorët dhe t'i përdorin drejt ata.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-7 në *Fletoren e punës*, fq. 44, 45 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre .

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Rrethanori i vendit dhe i kohës

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të dallojnë rrethanorët e vendit dhe të kohës dhe t'i përdorin drejt ata në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- pyet, nëse e kanë lexuar librin “*Një udhëtim me Kon Tikin*” dhe, në qoftë se po, u kërkon të thonë përmbajtjen e tij;
- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 65 tekstin “*Në ishujt e Polinezisë*”
- bën pyetjet: *Kush flet në këtë tekst? Për çfarë flet? Çfarë është ky tekst: një lajm, një përshkrim, një tregim? U kërkon të argumentojnë mendimin e tyre. Vijon me pyetjet: Çfarë tregojnë fjalët me shkronja blu? Me çfarë pyetjeje gjenden? Me cilat fjalë lidhen? Çfarë funksioni kryejnë në fjali? Çfarë gjymtyre e fjalisë janë? A mund të hiqen ose të zhvendosen? dhe u kërkon ta provojnë;*
- nxjerrin përfundimin që rrethanori *i vendit* tregon vendin ku kryhet veprimi, vendin ku ndodhet, nga vjen ose nëpërmjet të cilit kalon ai që kryen veprimin. Rrethanori *i vendit* u përgjigjet pyetjeve *ku, në ç’vend* për të treguar pozicionin ku kryhet veprimi, kurse pyetjeve *që nga, nga, për ku* për të treguar zhvendosjen dhe drejtimin e lëvizjes. Ai mund të zhvendoset dhe të hiqet pa prishur kuptimin e fjalisë;
- u kërkon të lexojnë fjalitë : *Jashtë frynte erë. Vende-vende rruga ishte me gropa. Në qytetin tim flitej shumë për zgjedhjet e reja. Rrugëve shiheshin turma njerëzish të shqetësuar. Isha nisur tek ti. Vuajtjet, ma tepër se koha, kishin lanë në faqet e tij të vrazhda gjurmë të thella.*
- bën pyetjet: *Me cilat fjalë lidhen fjalët me shkronja të zeza? Çfarë pyetjeje u përgjigjen? Çfarë funksioni kryejnë në fjali? Me se janë shprehur?*
- nxjerrin përfundimet që rrethanori *i vendit* shprehet me *ndajfolje* ose *lokucion ndajfoljor*, me *emër* ose *përemër* me ose pa parafjalë, me *grup emëror*.

Ora e dytë

Synimi: të përforcojnë njohuritë e fituara për rrethanorët e vendit dhe të kohës dhe t'i përdorin drejt ata.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë fragmentin e shkëputur nga teksti “*Në ishujt e Polinezisë*”;^{*}
- bën pyetjet: *Me cilat fjalë lidhen fjalët me shkronja rozë? Çfarë tregojnë ato? Çfarë funksioni kryejnë në fjali? Çfarë gjymtyre e fjalisë janë? Çfarë pyetjeje u përgjigjen? A mund të hiqen ose të zhvendosen? Provojeni.;*
- nxjerrin përfundimin që rrethanori *i kohës* tregon çastin kur kryhet veprimi ose shtrirjen në kohë të tij, pra ç’pjesë kohe ngërthen një veprim;
- u kërkon të lexojnë fjalitë: *Ndeshja finale do të zhvillohet nesër. Ndeshje të tilla zhvillohen herë pas here. Ndeshja finale u zhvillua para një jave. Festivali u zhvillua para një muaji. Ndeshja finale u zhvillua të dielën e kaluar. Festivali u zhvillua muajin e kaluar. U kujtova duke dalë. Vera u largua pa u gdhirë.;*
bën pyetjet: *Me cilat fjalë lidhen fjalët me shkronja të zeza? Çfarë pyetjeje u përgjigjen? Çfarë funksioni kryejnë në fjali? Me se janë shprehur?;*

- nxjerrin përfundimin që rrethanori i kohës u përgjigjet pyetjeve: *kur?, që kur?, deri kur?, për sa kohë?, që ndërtohet me ndajfolje ose shprehje ndajfoljore, me emër me ose pa parafjalë, me grup emëror ose me një formë të pashtjelluar të foljes;*

Ora e tretë

Synimi: të përforcojnë njohuritë e fituara për rrethanorët e vendit dhe të kohës dhe t'i përdorin drejt ata.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-7 në *Fletoren e punës*, fq. 46, 47, 48 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre .

Vërejtje: nëse mësues-i/ja e sheh të nevojshme, mund të bëjë edhe një kombinim tjetër të ushtrimeve me lëndën e re, duke ruajtur numrin prej tri orësh për këtë njësi mësimore.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Rrethanori i shkakut dhe i qëllimit

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të dallojnë rrethanorët e shkakut dhe t'i përdorin drejt ata në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 67 tekstin “*Shekspiri dhe unë*”;
- bën pyetjet: *Kush e ka shkruar këtë tekst? Për çfarë flitet në këtë tekst? Me cilat fjalë lidhen fjalët me shkronja blu? Çfarë tregojnë ato? Çfarë pyetjeje u përgjigjen? Çfarë funksioni kryejnë në fjali? Çfarë gjymtyre e fjalisë janë? Me se janë shprehur? A mund të hiqen ose të zhvendosen? dhe u kërkon ta provojnë;*
- nxjerrin përfundimin që rrethanori *i shkakut* tregon shkakun e kryerjes së veprimit ose të pranisë së një dukurie, që ai varet nga folja, ndonjëherë edhe nga mbiemri dhe që gjendet me anë të pyetjeve *pse?, për ç’shkak? për ç’arsye?* drejtuar foljes;
- u kërkon të lexojnë fjalitë: *Ç’pate, pse nuk fjete? Më kishte ikur gjumi nga gëzimi. Më ishte tharë fyti nga etja e madhe. Isha lodhur duke vallëzuar;*
- bën pyetjet: *Me cilat fjalë lidhen fjalët me shkronja të zeza? Çfarë pyetjeje u përgjigjen? Çfarë funksioni kryejnë në fjali? Me se janë shprehur?;*
- nxjerrin përfundimet që rrethanori *i shkakut* shprehet me një emër ose grup emëror me *parafjalë*, me ndajfoljen *pse* dhe me *përcjellore*.

Ora e dytë

Synimi: të aftësohen të dallojnë rrethanorët e qëllimit dhe t'i përdorin drejt ata në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë tekstin “*Muji dhe zanat*”;
- bën pyetjet: *Me cilat fjalë lidhen fjalët me shkronja blu? Çfarë tregojnë ato? Çfarë pyetjeje u përgjigjen? Çfarë funksioni kryejnë në fjali? Çfarë gjymtyre e fjalisë janë? Me se janë shprehur? A mund të hiqen ose të zhvendosen? dhe u kërkon ta provojnë;*
- nxjerrin përfundimin që rrethanori *i qëllimit* varet nga folja dhe tregon qëllimin e kryerjes së një veprimi. Rrethanori *i qëllimit* u përgjigjet pyetjeve *përse? për ç’qëllim?, me ç’qëllim?* drejtuar foljes;
- u kërkon të lexojnë fjalitë : *Përse nuk punoni? Kemi shkuar jashtë për punë. Kemi punuar gjithë ditën për rregullimin e rrugës. Ka shkuar në Belgjikë për t’u specializuar;*
bën pyetjet: *Me cilat fjalë lidhen fjalët me shkronja të zeza? Çfarë pyetjeje u përgjigjen? Çfarë funksioni kryejnë në fjali? Me se janë shprehur?;*
- nxjerrin përfundimin që rrethanori *i qëllimit* shprehet me ndajfoljen *përse*, me një emër ose grup emëror me *parafjalë*, ose me një *paskajore*, që marrëdhëniet qëllimore, kur janë të shprehura me një emër me *parafjalën për*, i varur nga folje që tregojnë lëvizje gërshetohen me marrëdhëniet kundrinore.

Ora e tretë

Synimi: të përforcojnë njohuritë e fituara për rrethanorët e shkakut dhe të qëllimit dhe t'i përdorin drejt ata.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-8 në *Fletoren e punës*, fq. 49, 50, 51 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre .

Vërejtje: nëse mësues-i/ja e sheh të nevojshme, mund të bëjë edhe një kombinim tjetër të lëndës së re me ushtrimet, duke ruajtur numrin prej tri orësh për këtë njësi mësimore.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Rrethanori i mënyrës dhe i sasisë

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të dallojnë rrethanorët e mënyrës dhe t'i përdorin drejt ata në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- i pyet nëse e kanë lexuar librin e Mark Tuen “*Tom Sojeri*” dhe, në qoftë se po, u kërkon të flasin për përmbajtjen e tij;
- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 69 tekstin “*Tomi lyen gardhin*”;
- bën pyetjet: *Kush flet në këtë tekst? Për çfarë flet? Çfarë është ky tekst: një lajm, një përshkrim, një tregim?* U kërkon ta argumentojnë mendimin e tyre dhe vijon me pyetjet: *Me cilat fjalë lidhen fjalët me shkronja blu? Çfarë tregojnë ato? Me çfarë pyetjeje gjenden? Çfarë funksioni kryejnë në fjali? Çfarë gjymtyre e fjalisë janë? Me se janë shprehur? A mund të hiqen ose të zhvendosen?* dhe u kërkon ta argumentojnë;
- nxjerrin përfundimin që rrethanori i mënyrës tregon mënyrën si kryhet veprimi i treguar nga folja dhe që rrethanori i mënyrës i përgjigjet pyetjes *si?* drejtuar foljes;
- u kërkon të lexojnë fjalitë: *Në zemrat e reja kënga rridhte vetvetiu. Bora mbuloi shpejt e shpejt gjithçka. Duhet ta lyejmë me dëshirë. Duhet të lyejmë me shpejtësi të madhe. Tomi lyente duke kënduar. Tomi lyente pa folur.*;
- bën pyetjet: *Me cilat fjalë lidhen fjalët me shkronja të zeza? Çfarë pyetjeje u përgjigjen? Çfarë funksioni kryejnë në fjali? Me se janë shprehur?*;
- nxjerrin përfundimet që rrethanori i mënyrës shprehet me një *ndajfolje* ose *shprehje ndajfoljore*, me një *emër* ose *grup emëror*, me *formë të pashtjelluar* të foljes.

Ora e dytë

Synimi: të aftësohen të dallojnë rrethanorët e sasisë dhe t'i përdorin drejt ata në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë fragmentin e marrë nga teksti “*Tomi lyen gardhin*”;
- bën pyetjet: *Me cilat fjalë lidhen fjalët me shkronja rozë? Çfarë tregojnë ato? Çfarë pyetjeje u përgjigjen? Çfarë funksioni kryejnë në fjali? Çfarë gjymtyre e fjalisë janë? Me se janë shprehur? A mund të hiqen ose të zhvendosen?* dhe u kërkon ta provojnë;
- nxjerrin përfundimin që fjalët me shkronja rozë janë rrethanorë sasië, që rrethanori *i sasisë* tregon masën e veprimit, të kohës, të hapësirës ose shkallën e një cilësie a mënyre veprimi dhe i përgjigjet pyetjes *sa?* drejtuar foljes;
- u kërkon të lexojnë fjalitë: *Teuta e vogël hëngri pak. Përkundrazi, Astriti hëngri sa për katër. Ai duhet të lyente tridhjetë metra mur dërrase me një lartësi prej gati dy metrash.. E përsëriti edhe një herë këtë veprim, pastaj për së treti.*;
- bën pyetjet: *Me cilat fjalë lidhen fjalët me shkronja të zeza? Çfarë pyetjeje u përgjigjen? Çfarë funksioni kryejnë në fjali? Me se janë shprehur?*;
- nxjerrin përfundimin që rrethanori sasisë shprehet me një *ndajfolje* ose *shprehje ndajfoljore* dhe me një *grup emëror* (*zakonisht numëror + emër*).

Ora e tretë

Synimi: të përforcojnë njohuritë e fituara për rrethanorët e mënyrës dhe të sasisë dhe t'i përdorin drejt ata.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-9 në *Fletoren e punës*, fq. 52, 53, 54, 55 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre .

Vërejtje: nëse mësues-i/ja e sheh të nevojshme, mund të bëjë edhe një kombinim tjetër të lëndës së re me ushtrimet, duke ruajtur numrin prej tri orësh për këtë njësi mësimore.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Mësimi 25

Letra

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të dallojnë letrat zyrtare nga letrat jozyrtare dhe të shkruajnë vetë letra zyrtare dhe jozyrtare.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- pyet se çfarë mjetesh përdorim sot për të komunikuar me të tjerët, çfarë është letërkëmbimi, nëse kanë dërguar ose marrë letra, nga kush dhe me çfarë rasti kanë shkruar ose marrë letra etj.;
- nxjerrin përfundimin që letra, edhe pse në ditët e sotme kanë marrë përhapje të gjërë telefoni, faksi dhe posta elektronike (e-mail), mbetet një nga mjetet e rëndësishme të komunikimit;
- u kërkon të vështrojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 74 zarfin e letrës të shkruar në të dy anët e tij;
- bën pyetjet: *Kujt i drejtohet letra? Ku banon marrësi i letrës? Si i gjetët? Çfarë ka në pjesën e sipërme të zarfit, djathtas? Çfarë të dhënash ka në vulën e postës? Çfarë është shkruar në anën tjetër të zarfit? Kush e dërgon letrën? Për ç'arsye dërguesi e ka shkruar adresën e vet?;*
- nxjerrin përfundimin që në anën e prapme të zarfit duhet të jetë emri, mbiemri dhe adresa e marrësit, ndërsa nga ana e përparme e zarfit duhet të jetë emri, mbiemri dhe adresa e dërguesit;
- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq 75, letrën e Bertit drejtuar nënës;
- bën pyetjet: *Kush e ka shkruar letrën? Kur është shkruar letra? Ku është shkruar? Me ç'rast është shkruar letra? Pse është larguar djali pa lajmëruar? Për çfarë është i shqetësuar ai? U kërkon të lexojnë pjesën ku ai i kërkon falje nënës dhe i pyet : *Nga kuptohet që djali ka besim për të ardhmen? Me kë është njohur Berti? Ku është njohur me Adrianin? Çfarë do të thotë shkurtimi P.S.? A është pjesë e detyrueshme e letrës? Çfarë letre është kjo, private apo zyrtare? dhe u kërkon ta argumentojnë përgjigjen;**
- nxjerrin përfundimin që hartimi i një letre ka disa rregulla, që personi të cilit i drejtohet letra është i ndjeshëm fillimisht ndaj paraqitjes së letrës, i cila duhet të plotësojë disa kërkesa, që përmbajtja e letrës ndryshon në varësi nga synimi i atij që e shkruan letrën dhe në varësi të veçorive të atij që i drejtohet letra, që letra mund të jetë zyrtare dhe jozyrtare. Letra jozyrtare u drejtohet njerëzve të familjes, shokëve ose të afërmeve, shkruhet me dorë dhe me një gjuhë relativisht të çlirët. Ajo duhet të përmbajë kokën (datën, vendin e dërgimit), kujt i drejtohet, tekstin (përmbajtjen) dhe përshëndetjen e nënshkrimit e autorit etj.

Ora e dytë

Synimi: të aftësohen të dallojnë letrat zyrtare nga letrat jozyrtare dhe të shkruajnë vetë letra zyrtare dhe jozyrtare.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u thotë të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 76 letrën dërguar Bashkisë së qytetit;
- u kërkon të krahasojnë letrën e parë me të dytën. Bën pyetjet: *Kujt i drejtohet letra e parë dhe kujt i drejtohet letra e dytë? Në çfarë forme i drejtohen marrësit të letrës? Çfarë dallimi*

vini re në mënyrën e përshëndetjes dhe në nënshkrimin e këtyre dy letrave? Çfarë letrë është e dyta, zyrtare apo jozyrtare? dhe u kërkon ta argumentojnë përgjigjen;

- nxjerrin përfundimin që letra zyrtare u drejtohet institucioneve ose personave zyrtarë dhe që ajo, zakonisht, është *e shtypur* dhe me një gjuhë *të kontrolluar e të kujdesshme*.

Ora e tretë

Synimi: të përforcojnë njohuritë e fituara për letrën dhe të aftësohen për të shkruar vetë letra private dhe zyrtare.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-9 në *Fletoren e punës*, fq. 56, 57, 58, 59, 60 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre .

Vërejtje: nëse mësues-i/ja e sheh të nevojshme, mund të bëjë edhe një kombinim tjetër të lëndës së re me ushtrimet, duke ruajtur numrin prej tri orësh për këtë njësi mësimore.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Ftesa

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të dallojnë ftesat zyrtare nga ftesat private dhe të shkruajnë vetë ftesa zyrtare dhe private.

Janë të nevojshme: ftesa të ndryshme zyrtare ose jo zyrtare që lidhen me ngjarje të zhvilluara në shkollë ose në mjedisin ku jetojnë.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- pyet se çfarë janë ftesat, nëse kanë dërguar ose marrë ftesa, nga kush dhe me çfarë rasti kanë shkruar ose marrë ftesa etj.;
- u kërkon të lexojnë ftesën zyrtare në *Librin e nxënësit*, fq. 77;
- bën pyetjet: *Kush e ka publikuar këtë tekst? Kujt i drejtohet? Për çfarë i drejtohet? Përse shënohet data? Çfarë është ky tekst: njoftim, ftesë, letër?* dhe u kërkon ta argumentojnë me të dhëna nga teksti përgjigjen e tyre;
- nxjerrin përfundimin që ftesa është teksti në të cilin dikush fton dikë të marrë pjesë në ndonjë ngjarje (manifestim kulturor, sportiv, takim, gëzim etj.);
- u kërkon të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 77, 78 dy ftesat në vijim;
- bën pyetjet: *Çfarë janë dy tekstet e mësipërme? U kërkon ta argumentojnë përgjigjen e tyre me të dhëna nga tekstet. Bën pyetjet: Kush e dërgon ftesën e parë? Kujt i drejtohet? Si arritët në këtë përfundim? Si quhet ftesa që i drejtohet një shoku ose një të afërmi? Kush e dërgon ftesën e dytë? Kujt ia adreson? Si arritët në këtë përfundim? Si quhet ftesa që dërgohet nga një institucion zyrtar? A mund të lihet ftesa zyrtare në kutinë postare ose të varet në tabelën e lajmërimeve? Çfarë të dhënash duhet të përmbajë një ftesë, pavarësisht në se ajo është zyrtare ose jozyrtare?;*
- nxjerrin përfundimin që ftesat mund të jenë zyrtare dhe jozyrtare, që ftesat jozyrtare u drejtohen njerëzve të familjes, shokëve ose të afërmëve dhe shkruhen me një gjuhë relativisht të çlirët. Ftesat zyrtare u drejtohen institucioneve ose personave zyrtarë dhe, zakonisht, janë të shtypura dhe me një gjuhë të kontrolluar e të kujdesshme. Ftesa zyrtare mund t'i drejtohet një njeriu ose shumë njerëzve.

Ora e dytë

Synimi: të aftësohen të dallojnë ftesat zyrtare nga ftesat jozyrtare dhe të shkruajnë vetë ftesa zyrtare dhe jozyrtare.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u thotë të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 76, fjalitë ftesë për festivalin e fëmijëve;
- bën pyetjet: *Kush fton? Kë fton? Kur e fton? Ku e fton? Për çfarë e fton? Çfarë mungon në këtë ftesë?* dhe u kërkon ta plotësojnë me të dhënat që mungojnë;
- nxjerrin përfundimin që ftesa të jetë e plotë duhet t'u përgjigjet pyetjeve : *Kush fton? Kë fton? Për se e fton? Kur zhvillohet aktiviteti? Ku zhvillohet?*
- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-6 në *Fletoren e punës*, fq. 62-65 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre .

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Justifikimi

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të dallojnë justifikimet zyrtare dhe jozyrtare dhe të shkruajnë vetë justifikime zyrtare dhe jozyrtare

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- pyet se çfarë janë justifikimet, nëse janë justifikuar për diçka, për se janë justifikuar, si janë justifikuar dhe me çfarë rasti;
- u kërkon të lexojnë justifikimin drejtuar mësuese Verës për Arlën në *Librin e nxënësit*, fq. 79;
- bën pyetjet: *Kush e ka shkruar tekstin? Kujt i drejtohet teksti? Pse është shkruar ky tekst? Sa data ka në tekst? Çfarë tregojnë ato? Si quhet teksti që prindi i shkruan mësuesit kujdestar për të arsyetuar mungesën e fëmijës së vet në shkollë?*;
- nxjerrin përfundimin që justifikimi është teksti që shkruajmë kur nuk e kemi bërë si duhet diçka, që justifikimi i shkruar duhet të përmbajë këto të dhëna: *kujt i drejtohet, kush e shkruan, kë justifikon (ose kush justifikohet), për çfarë justifikohet, ku, kur dhe për ç'arsye ka ndodhur ngjarja, lutja për justifikim*. Toni i justifikimit duhet të jetë njerëzor, i kulturuar dhe i edukuar;
- u kërkon të lexojnë justifikimin e Markos për mungesën e vajzës së saj në *Librin e nxënësit*, fq. 77;
- bën pyetjet: *Çfarë është ky tekst?* U kërkon ta argumentojnë me të dhëna nga teksti. Bën pyetjet: *Çfarë mungon në këtë tekst? Çfarë duhet shtuar që të bëhet i plotë?*;
- nxjerrin përfundimin që ky tekst është një justifikim, që në këtë justifikim mungon emri i atij të cilit i drejtohet justifikimi, mungon emri i atij ose asaj që justifikohet prej tij, mungon data kur ka munguar, nuk është i plotë emri i atij që e ka shkruar;
- u kërkon të lexojnë justifikimin e Danicës për mbesën e saj në *Librin e nxënësit*, fq. 79 .
- bën pyetjet: *Çfarë është ky tekst? Çfarë mungon në këtë tekst? A është i saktë ky tekst?* dhe u kërkon ta argumentojnë;
- nxjerrin përfundimin që ky tekst është një justifikim, që në këtë justifikim mungon emri i atij të cilit i drejtohet justifikimi, mungon data kur ka munguar, mungon arsyeja e justifikimit ose për çfarë gjëje kërkohet justifikimi, nuk është i plotë emri i atij që e ka shkruar;

Ora e dytë

Synimi: të aftësohen të dallojnë justifikimet zyrtare nga justifikimet jozyrtare dhe të shkruajnë vetë justifikime zyrtare dhe jozyrtare.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u thotë të lexojnë në *Librin e nxënësit*, fq. 80 justifikimin e Spitalit për Zanën;
- bën pyetjet: *Çfarë është ky tekst? Çfarë të dhënash përmban? Si quhet ky tekst që është lëshuar nga një institucion për të arsyetuar mosmarrjen pjesë në mësim të një nxënësi? Çfarë ndryshimi ka ky tekst nga të tjerët? Ky tekst është justifikim: a) zyrtar apo b) jozyrtar?* U kërkon ta argumentojnë përgjigjen. Vijon me pyetjen: *Po tekstet e tjera a janë: zyrtare apo jozyrtare?*
- nxjerrin përfundimin që justifikimet janë zyrtare dhe jozyrtare, që ata që shkruajnë një

justifikim duhet të kenë kujdes që letra të mos jetë e zhubrosur, që të jenë në vendin e duhur fjalët hyrëse, koka, teksti, mbyllja etj., që shkrimi të jetë i qartë dhe ajo që shkruhet të jetë e saktë. Nuk duhet harruar në fund përsëritja dhe nënshkrimi;

Ora e tretë

Synimi: të përforcojnë njohuritë e fituara për justifikimin dhe të aftësohen për të shkruar vetë justifikime zyrtare dhe jozyrtare.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- Bën pyetjet: *Ç'është justifikimi? Cilat janë llojet e justifikimeve? Çfarë të dhënash duhet të përmbajë një justifikim me shkrim? Cilat fjalë duhet të përdorim në justifikimin me gojë? Ku dallohen justifikimet zyrtare nga ata jozyrtare?*
- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-6 në *Fletoren e punës*, fq. 66-68 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre .

Vërejtje: nëse mësues-i/ja e sheh të nevojshme, mund të bëjë edhe një orë shtesë për këtë temë.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Rendi i gjymtyrëve të dyta

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të dallojnë vendin e gjymtyrëve të dyta në fjali dhe t'i përdorin drejt ata në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë në Tekstin mësimor, fq. 81 fjalitë: *Vajzat u larguan të kënaqura. Ato e ndjenin veten të lumtura.*;
- bën pyetjet: *Çfarë fjalish janë? Cilat janë gjymtyrët kryesore të këtyre fjalive? Cili është rendi i tyre? Çfarë janë fjalët me shkronja të zeza? Cili është rendi i përcaktorëve kallëzuesorë në këto fjali?* U kërkon t'i ndryshojnë vendin përcaktorëve kallëzuesorë dhe i pyet se çfarë vënë re;
- nxjerrin përfundimin që rendi *kryefjalë+kallëzues+përcaktor kallëzuesor* është rend i drejtë, që rendi *kryefjalë+kallëzues+kundrinor i drejtë+përcaktor kallëzuesor* është rend i drejtë dhe që rendet e tjera të mundshme janë rende të anasjelltë, emfatike ose emocionale;
- u kërkon të vështrojnë tabelën që shënon vendin e kundrinorëve në fjali;
- bën pyetjet: *Çfarë fjalish janë? Cilat janë gjymtyrët kryesore të këtyre fjalive? Cili është rendi i tyre? Çfarë janë fjalët me shkronja të zeza? Cili është rendi i kryefjalëve, i kallëzuesve dhe i kundrinorëve në këto fjali?* U kërkon t'i ndryshojnë vendin kundrinorëve dhe i pyet se çfarë vënë re;
- nxjerrin përfundimet që rendi *kryefjalë+kallëzues+kundrinor i drejtë* është rend i drejtë dhe në disa raste i detyrueshëm, që rendi *kundrinor i drejtë+kallëzues+kryefjalë* është rend i anasjelltë, emfatik ose emocional, që rendi *kryefjalë+kallëzues+kundrinor i zhdrejtë* pa parafjalë është rend i drejtë, që rendi *kryefjalë+kallëzues+kundrinor i zhdrejtë* me parafjalë është rend i drejtë, po që edhe e kundërta është e mundur;

Ora e dytë

Synimi: të aftësohen të dallojnë vendin e gjymtyrëve të dyta në fjali dhe t'i përdorin drejt ata në gjuhën e folur dhe të shkruar.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të vështrojnë tabelën që shënon vendin e rrethatorëve në fjali;
- bën pyetjet: *Çfarë fjalish janë? Cilat janë gjymtyrët kryesore të këtyre fjalive? Cili është rendi i tyre? Çfarë janë fjalët me shkronja të zeza? Cili është rendi i rrethatorëve në këto fjali?* U kërkon t'i ndryshojnë vendin rrethatorëve dhe i pyet se çfarë vënë re;
- nxjerrin përfundimet që vendi i rrethatorëve në përgjithësi nuk është i ngulitur. Zakonisht vihen pas foljeve, por për arsye të ndryshme vihen edhe përpara.

Ora e tretë

Synimi: të përforcojnë njohuritë e fituara për rendin e rrethatorëve dhe t'i përdorin drejt ata.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-4 në *Fletoren e punës*, fq. 69-70 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre .

Vërejtje: nëse mësues-i/ja e sheh të nevojshme, mund të bëjë edhe një kombinim tjetër të lëndës së re me ushtrimet, duke ruajtur numrin prej tri orësh për këtë njësi mësimore.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Shkronja e madhe tek emrat

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të dallojnë emrat e përveçëm dhe t'i shkruajnë drejt ata.

Janë të nevojshme: ilustrime nga gërmimet arkeologjike dhe kopje e bustit ose fotografi të Deas së Butrintit.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të thonë se çfarë janë zbulimet arkeologjike, nëse kanë pasur rastin të vizitojnë ndonjë qendër arkeologjike;
- u tregon një foto ose, nëse është e mundur, bustin e Deas së Butrintit. Zhvillojnë një bisedë mbi këtë vepër të antikitetit;
- u thotë të lexojnë tekstin: “*Dea e Butrintit*” në *Librin e nxënësit* fq. 83;
- bën pyetjet: *Çfarë janë fjalët me shkronja blu? Si janë shkruar ato? Përse janë shkruar me shkronja të mëdha në fillim?*;
- nxjerrin përfundimin që emrat e përveçëm shkruhen me shkronjë të madhe në fillim;
- u kërkon të vështrojnë tabelën me emrat dhe mbiemrat e përveçëm;
- bën pyetjen: *Cilët lloje emrash të përveçëm shkruhen me shkronjë të madhe në fillim?*
- nxjerrin përfundimet që emrat dhe mbiemrat e njerëzve, epitetet dhe ofiqet, pseudonimet, emrat e përveçëm të kafshëve, emrat e planetëve dhe të yjeve, emërtimet gjeografike dhe të vendeve, emërtimet e institucioneve dhe të partive, emërtimet e periudhave dhe ngjarjeve historike, emërtimet e monumenteve të kulturës shkruhen me shkronjë të madhe në fillim;

Ora e dytë

Synimi: të aftësohen të dallojnë emrat e përveçëm dhe t'i shkruajnë drejt ata.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të vështrojnë tabelën me emra të përveçëm të librave, gazetave etj.;
- bën pyetjen: *Cila pjesë e këtyre emrave të përveçëm shkruhet me shkronjë të madhe?*;
- nxjerrin përfundimet që titujt e librave, të gazetave, emrat e rrugëve dhe të firmave, emrat e përgjithshëm të personifikuar, emrat e shteteve, të partive, organizatave, shoqatave, institucioneve shkruhen me shkronjë të madhe në fillim;

Ora e tretë

Synimi: të përforcojnë njohuritë e fituara për shkronjën e madhe tek emrat e përveçëm dhe ta përdorin drejt atë.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-6 në *Fletoren e punës*, fq. 71, 72 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre .

Vërejtje: nëse mësues-i/ja e sheh të nevojshme, mund të bëjë edhe një kombinim tjetër të lëndës së re me ushtrimet, duke ruajtur numrin prej tri orësh për këtë njësi mësimore.

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Shkrimi i datave

Ora e parë

Synimi: të aftësohen të shkruajnë drejt datat.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të thonë se çfarë janë vendimet zyrtare, kush i merr, përse i merr dhe ku publikohen; u tregon tekste të ndryshme zyrtare, ndër të cilat edhe fletore zyrtare me vendimet përkatëse;
- u thotë të lexojnë në Librin e nxënësit tekstin : “V e n d i m Nr. 201, datë 29.4.2007”
- bën pyetjet: *Për çfarë flitet në këtë vendim? Kush e ka marrë vendimin? Kur e ka marrë vendimin? Kujt i drejtohet vendimi? Pse ky vendim është zyrtar? Kur do të zbatohet ky vendim? Çfarë vini re në gjuhën e këtij teksti? Çfarë janë fjalët me shkronja blu? Si janë shkruar fjalët me shkronja blu?*
- nxjerrin përfundimin që vendimet zyrtare merren nga institucione shtetërore që gjuha e tyre është pa fjalë të tepërta dhe pa kuptime të figurshme. Në shkrimin e datave, kur muaji shkruhet me shifra arabe, pas shënimit të datës dhe të muajit vihet një pikë: 29. 4. 2007;
- u kërkon të vështrojnë shkrimin e tre grupeve të datave në vijim;
- bën pyetjet: *Cili shkrim është i saktë në grupin e parë? Po në grupin e dytë dhe të tretë? U kërkon të shpjegojnë veçoritë e çdo njërit prej tyre;*
- nxjerrin përfundimet që, kur në datat, muaji shkruhet me shifra romake, pas shënimit të datës dhe të muajit, vihet një pikë (29. IV. 2007), që, kur në datat muaji shkruhet me shkronja, nuk vihet asnjë shenjë midis ditës, muajit dhe vitit (29 prill 2000), që në shkresat zyrtare, në shkrimin e datave, pas emrit të vendit, vihet presje dhe para shifrës që shënon datën, vihet parafjala *më* (Podgoricë, më 25. 4. 2007 ose Podgoricë, më 25. IV. 2007).

Ora e dytë

Synimi: të aftësohen të shkruajnë drejt datat.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të lexojnë fjalitë: *Kongresi u hap të hënën, më 20. XI. 2007. Mbledhja bëhet të shtunën, më 1 shtator 2007.;*
- bën pyetjet: *Çfarë funksioni kanë në fjali fjalët me shkronja të zeza? Çfarë fjale vihet para datave, kur ata përdoren si rrethanaorë kohe?;*
- nxjerrin përfundimin që, kur datat përdoren si *rrethanaorë kohe*, para tyre vihet gjithmonë parafjala *më*.

Ora e tretë

Synimi: të përforcojnë njohuritë e fituara për shkrimin e datave.

Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-4 në *Fletoren e punës*, fq. 73, 74 dhe të verifikojnë përmes diskutimit realizimin e tyre .

Vërejtjet e mësues-it/-es:

Zgjidhjet e ushtrimeve të fletores së punës

1. Biseda telefonike

1. *zyrtare, jozyrtare; mënyra e prezantimit; sesi i drejtohen; nga gjuha.*
2. A. + zyrtare; _jozyrtare
B. _+_ kulturës së të folurit të bashkëbiseduesit;
+ temës së bisedës;
+ përmendjes së emërtimeve të institucioneve;
+ përmendjes së emrit të bashkëfolësit;
+ nga mënyra si i drejtohet bashkëbiseduesit (përdoret përemri Ju);
+ nga mënyra e përfundimit të bisedës

2. Gjuha letrare dhe dialektet

1. a) *shkollë, radio, televizion; b) gegërishten, toskërishten; c) toskërishten* ____ .
2. **Shkruani në cilin dialekt përdoret secili nga këto grupe fjalësh.**
gegërisht; toskërisht
fshat, qumësht, skuq, gënjej, fshehurazi; çelës, gjel, dhelpër
4. *ëmbël, këngë, dhëmb, syri, pruri, bëri, është duke mësuar, është duke kënduar, është duke lexuar, kam zgjidhur, kam lënë, kam prerë*
5. Askush s'e njeh Lulin. As shokët e tij, që përpara tij lozin, nuk e njohin. Më mirë të thuhet se e njohin, por ata lozin për hesap të vet dhe Luli i shikon për hesap të vet. Sot gjithkush ka punët dhe telashet e veta, ashtu edhe fëmijët, ashtu edhe Luli.
– More Lul! Shumë herët ke filluar të shikosh punën tënde.

3. Kuptimi i fjalëve

1. *c; a; c; ç; a; b;*
2. **Cili është kuptimi i fjalës *grykë* në tri tekstet më poshtë?**
I. pjesë e trupit të kafshës; II. pjesë e shishes; III. pjesë e trupit të njeriut
3. **Cili është kuptimi i fjalës *çelës* në fjalitë që vijojnë.**
a) pjesë metalike që shërben për të hapur diçka; b) shenjë muzikore
c) mjet që përdoret nga hidraulikët; ç) çelsi i dritës; d) zgjidhje
4. *_2_ letër urimi; _1_ letër cigareje; _1_ kosh letrash; _2_ letër zyrtare;*
2 mori letër; _2_ letër e thjeshtë; _1_ letër me ngjyra; _2_ letërkëmbim,
5. a) *mbledhja e barit, mbledhja e ullinjve, mbledhja e fjalëve të rralla*
b) *mbledhja dhe zbritja, mbledhja e numrave*
c) *sallë mbledhjesh, foli në mbledhje*

4. Sinonimet, antonimet dhe homonimet

1. *U fikën dritat. Të gjithë u trembën. Disa ikën me vrap.*
Vrapova dhe unë me sa munda.
2. *kishte qeshur; e errët; e lehtë; brenda; uli; largoi; la; të fundit; ngriti; rrëzua; u njom; lindi; frikacaku*

3.

Fjala	Sinonimi	Antonim
i mërzhitur	i shqetësuar	i gëzuar
filloj	nis	lë
prish	shkatërroj	rregulloj
i guximshëm	trim	frikacak
i papërtueshëm	punëtor	dembel

5. Shënoni + para fjalëve antonime.

_ dal- nuk dal; _+_ dal – hyj; _ i vështirë – jo i vështirë; _+_ i vështirë - i lehtë;
_ shko – mos shko; _+_ shko – eja; _+_ shko – ik; _+_ i ditur - i paditur;
_ i ditur - jo i ditur; _ i lodhur - jo i lodhur; _+_ i lodhur - i palodhur,

5. Biografia

1. *biografi; autobiografi*
2. *a); d)*

6. Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë

1. 1) ligjëratë e drejtë
2. *Agroni pyeti se kur nisej avioni.
Ai tha se ishte penduar që kishte ardhur me ne.
Mësuesi na tha se gjatë verës duhej të lexonim sa më shumë libra, sepse ata na ndihmonin shumë në formimin gjuhësor dhe në edukimin estetik.*
3. *Nëna i tha Mozës: "Fol."
Besniku, duke e përkëdhelur, i tha Mozës: "Qetësohu."
Pas pak pyeti Bertin: "A ka bërë ndonjë gabim Moza."*
4. a) *Tani dëgjojmë edhe nga fëmijët tanë: „S'mund të jetohej si më parë!"*
b) *"Përtacia për njeriun është si ndryshku për hekurin", - thoshte ai.*
c) *"Edhe në vështirësi njeriu s'duhet të bëhet zemërlepur", - tha baba.*

7. Fjalja e thjeshtë minimale dhe e zgjeruar

1. *e thjeshtë; minimal; e zgjeruar; minimale; e zgjeruar*
2. *a; b; a; a; b;*
3. *a; b; a; a; b; a; a;*

8. Llojet e fjalive

1. *a. dëftore; b. nxitëse; c. pyetëse; ç. dëshirore;*
2. **A. shtatë fjali**
B. a) 4 dëftore; b) 1 pyetëse; ç) 1 dëshirore; c) 1 nxitëse;
3. a) 2 dëshirore; b) 3 nxitëse;
4. a) 3 pyetëse të pjesshme _____; b) 2 pyetëse tërësore _____

5.

Fjali dëftore	Fjali pyetëse	Fjali dëshirore	Fjali nxitëse
<p>- Astriti zuri vend pranë dritares.</p> <p>- Më në fund autobusi u nis</p> <p>- Jashtë bënte ftohtë.</p> <p>- Nga autobusi zbritën vetëm 5-6 vetë.</p>	<p>- I kujt je ti, more bir?</p> <p>- A do të qëndrojmë në Tuz?</p> <p>- Sa minuta do të qëndrojmë këtu?</p>	<p>- Ardhshi shëndoshë!</p> <p>- Të kisha një çaj të nxehtë tani!</p>	<p>Shtyu pak më tej, të lutem!</p> <p>- Shofer, mbaje pak makinën.</p> <p>- Hidhe krahëve pallton.</p>

9. Tregimi

1. *tregim*

2. *tregim*

3. *në vetën e tretë*

6. A) a) *tregimi*; b) *përshkrimi*

B) a) *Në oborrin e shtëpisë ku banoja unë, djali i një fqinji mbante një qen që e quanin Sharik. Të shkretin Sharik, pronari i tij e mbante gjithnjë të lidhur me zinxhir. Ai donte që ta bënte një qen të egër.*

Një ditë unë i solla qenit ca kocka pule, që ishin ende të ngrohta dhe që kundërmopin një erë të këndshme. Kjo erë duhet ta joshte qenin mishngrënës. Rastisi që, kur i prura këtë gjellë qenit, ishte koha kur djali e lironte atë nga zinxhiri.

b) *Shariku, me t'u zgjidhur, nuk i hodhi fare sytë nga kockat, por filloi të rrotullohej, të hidhej e të kërcente shumë i gëzuar në atë pak vend të oborrit të shtëpisë. Herë kërcente mbi borë, siç bëjnë lepujt, herë i ngrinte këmbët e para lart, herë kalonte nga njëra anë e herë nga tjetra. Shariku vinte edhe përreth meje, më kërcente sipër dhe, kur kalonte nga kockat, i nuhaste..., por nuk pushonte së kërcyeri. Nga qejfi se ishte zgjidhur, bënte lëvizje si budalla.*

7. *Përgjigjiuni pyetjeve*

A) *paraqitja ose ekspozimi, pika e lidhjes, zhvillimi, pika kulmore, zgjidhja*

B) *paraqitja ose ekspozimi*

10. Fjalitë dykryegjymtyrëse

1. *e thjeshtë, e përbërë; emëror, foljor; emër, kryefjalës; folje, kallëzuesit*

2. A. *shtatë fjali*

B. a) *katër të thjeshta;* b) *tri të përbëra*

3. A. *Tetë fjali*

B. a) *pesë fjali me folje;* b) *tri fjali pa folje*

4.

Fjalìa	Grupi emëror	Grupi foljor
	Çdo <u>mizë</u>	nuk <u>bën</u> mjaltë
	<u>Kali</u> i huaj	të <u>lë</u> në udhë
	<u>Shtëpia</u> pa libra	<u>është</u> si dhoma pa dritare
	<u>Vendi</u> ynë	<u>ka nxjerrë</u> burra të dëgjuar

5. A. pesë fjali

B. Është mbyllur festivali.


Në skenën e teatrit u ngjitën trupa teatrore.

Nata e parë u hap me trupën e Prishtinës

Festivali vijoi me trupën e Shkodrës.

Trupa konkurroi me “Ditari i një të çmenduri”.

6.



11. Fjalìa njëkryegjymtyrëshe emërore

njëkryegjymtyrëshe; emërore, foljore

2. __+__ Pranverë e acartë.

__+__ Buzëmbremje.

__+__ Heshtje.

__+__ Dy çadra të mëdha ushtarake.

__+__ Një kasolle e vogël në një lëndinë malore.

__+__ S'gjen domate më të mira se këto.

__+__ Blertës nuk i flihej.

C. Shtatë fjali

Ç.

Fjalja	Fjali emërore
	<u>Pranverë e acartë.</u>
	<u>Buzëmbremje.</u>
	<u>Heshtje.</u>
	Dy <u>çadra</u> të mëdha ushtarake.
	Një <u>kasolle</u> e vogël në një lëndinë malore.

3. Nënvizioni fjalitë njëkryegjymtyrëshe emërore.

Mrekullia vetë! ; Një tufë prej 1015 kokësh.; -Dhi të egra.; Mobilieri. ;

Enë kuzhine.; Kafe.; Konfeksione.; Bonboneri. ; Bar.;

Ja më në fund: Fotostudio.; Ndonjë pyetje?; Qetësi!

C. Dymbëdhjetë fjali

4. a) përshkruese;

b) treguese

12. Fjali njëkryegjymtyrëshe foljore

1. foljore; vetore; vetore; pavetore

2. 2; 1; 2; 1; 2; 1; 2; 1; 1;

C. pesë fjali njëkryegjymtyrëshe

Ç. pesë fjali njëkryegjymtyrëshe foljore

3.

Fjalitë	Veta e foljeve
<u>Shkojmë, shokë.</u>	Veta e parë shumës
<u>Ngrihemi.</u>	Veta e parë shumës
Të më <u>njoftosh</u> shpejt.	Veta e dytë njëjës
Na, <u>merre</u> librin.	Veta e dytë njëjës
<u>Shkoni, zotëri.</u>	Veta e dytë shumës
Atje tej nga parku ia <u>kishin marrë</u> këngës.	Veta e tretë shumës
Në qytet <u>flisnin</u> shumë për ndryshimet në qeveri.	Veta e tretë shumës
Te xha Selimi <u>erdhën</u> shumë njerëz.	Veta e tretë shumës
Njeriut t'i <u>shikosh</u> punën dhe jo fjalët.	Veta e dytë njëjës
<u>Bëje</u> të mirën e hidhe në det.	Veta e dytë njëjës

3. Çfarë fjalish njëkryegjymtyrëshe foljore janë?

Fjalitë	Vetore	Pavetore
Në qytet flisnin shumë për ndryshimet në qeveri.	+	
I ndodhi keq.		+
Qëlloi mirë.		+
Ashtu ndodhi.		+
Në rrugë ia kishin marrë këngës.	+	
Njeriut t'i shikosh punën dhe jo fjalët.	+	
Bëje të mirën dhe hidhe në det.	+	
Duart mund t'ia lidhësh njeriut, mendjen jo.	+	
Punën e sotme mos e lër për nesër.	+	

13. Kryefjala

1. Plotësoni fjalitë.

kryefjalë; kush, cili

2.

Fjalitë	Kryefjala e shprehur me
<u>Gratë</u> qajnë mesatarisht pesë herë në muaj.	Emër
<u>Meshkujt</u> më së shumti qajnë disa herë në vit.	Emër
<u>Shumë meshkuj</u> nuk qajnë kurrë.	Grup emëror
Prandaj <u>gratë</u> janë më të shëndosha.	Emër
<u>Lotët e grave</u> janë të një përbërjeje tjetër.	Grup emëror
Qendra e lotëve te gratë është më e ndjeshme.	Grup emëror
<u>Njerëzit e rinj</u> qajnë më shumë se të moshuarit.	Grup emëror
<u>Prodhimi i lotëve</u> pakësohet në pleqëri të të gjithë njerëzit.	Grup emëror

3. djemtë e një fshatari, i ati, djemtë, ai, vëllezërit, ai, ju

4. 1. I larë nga shiu i natës, qyteti shkëlqente nën rrezet e diellit.

2. Shtruar mbi fletët e barishteve, sumbullat e vesës përkulnin fijet e holla të barit.

3. Duke vozitur nga njëra rrjetë tek tjetra, peshkatarët e mblodhën gjahun pa ndonjë vështirësi të madhe.

5.

Gjethet dhe rrënjët

Një ditë të bukur vere, gjethet e një lisi po bisedonin me flladin dhe i mburrehin atij:

- A nuk jemi ne stolia e kësaj lugine? A nuk çlodhen nën hijen tonë udhëtarët e lodhur nga rruga dhe nga vapa e verës? Ti, o fllad, zor e ke të ndahesh prej nesh.

Jemi edhe ne për t' u falënderuar, u dëgjua një zë nga poshtë nën dhe.

- Kush guxon të flasë kështu? – fërshëllyen gjethet të zemëruara.

- Ne jemi ato që rritemi këtu në terr dhe ju ushqejmë. Ne jemi rrënjët e lisi. Po të thaheshim ne, do të zhdukeshit edhe ju, edhe lisi.

14. Kallëzuesi

1. Plotësoni fjalitë.

kallëzues; ç'bën? ç'është? si është?; foljor; jam, emër, mbiemër, përemër, grup emëror

2.

Kallëzuesi	Foljor	Emëro
do të rrethojnë	+	
do të këputin	+	
do t'vënë	+	
humbasim	+	
janë një rast		-
ka		+

3.

Kallëzuesi	Kallëzues foljor		Kallëzues emëror jam +			
	një folje	dy folje	emër	mbiemër	përemër	numëror grup emëror
lindi	+					
është fëmija i tretë	+					+
kishte qenë mesfushor	+		+			
kishte luajtur	+					
kishte përfunduar	+					
erdhi	+					
afroi	+					
mbushi						
shënoi						
luante						
shkëlqeu						
u bë						
luajti						
mundi të shënonte		+				

4. *pasoi* (foljor)
mundi të luante (foljor)
ishte i lënduar (emëror)
shënoi (foljor)
u bë (foljor)
është një nga futbollistët më të mirë (emëror)
luan (foljor)
është bërë (foljor)
ka bërë (foljor)

5.

Kallëzues...	Është shprehur me		
	një folje	dy folje	shprehje foljore
shikonte	+		+
mori frymë		+	
le të shkojmë		+	
desh ra		+	
qau e qau		+	
për të qarë qau		+	
filloi të qante		+	
zuri të qeshte		+	
nuk e zinte që nuk e zinte		+	
shkuan e vanë		+	

6.

Kallëzuesi emëror	Është shprehur me :			
	emër	mbiemër	përemër	numëror
1. është flori	+			
2. është e bukur		+		
3. është e popullit	+			
4. është me kuptim	+			
5. do të jetë një mësim	+			
6. është për ju			+	
7. ishin dhjetë.				+
8. ishin trembëdhjetë vjeç.				+

15. Lajmi dhe njoftimi

1. Qarko numrat që shënojnë shkrime në gazetë.

1. njoftim; 3. reportazh; 4. intervistë; 6. lajm

2. Lajmi është forma themelore e njoftimit në gazetë, radio ose televizion.

Lajmi jep të dhënat kryesore rreth një personaliteti, një ngjarjeje apo një fenomeni.

3. Lajmi duhet t'u japë përgjigje pyetjeve: kush? çfarë? kur? ku? si? përse?

4. Lajmi i shkurtër (anglisht flesh-i) është një njoftim i shkurtër që jepet për një ngjarje të rëndësishme e cila sapo është marrë vesh dhe për të cilën s'ka akoma informata të hollësishme

5. A) lajm

B) 1. Kush e ka filluar botimin e librave të reja për të rinj.

2. Vepra të kujt janë?; 3. Çfarë paraqesin këto vepra?

4. Ku do të paraqiten këto vepra?; 5. Ku zhvillohet panairi?

6. Kur zhvillohet?; 7. Ku është dhënë ky njoftim

6. A. shkrimi i parë

B. Jep të dhëna më të plota për problemin që trajtohet....

16. Përcaktori

1. përcaktor; emër, mbiemër, një formë e pashtjelluar

2.

Përcaktori	Është shprehur me :			
	emër	mbiemër	përemër	numëror
asnjë			+	
shqiptare		+		
i shenjtë		+		
ynë			+	
pa bari	+			
i turqve	+			
derëzestë		+		
të këtillë			+	

3.

Përcaktori	Është shprehur me :
shkëmb	emër
me erë	emër
bari	emër
ndonjë	përemër
e bardhë	mbiemër
ndonjë	përemër
e vogël	mbiemër
të dorës	emër
të tri	numëror
e arta	mbiemër
këtë	përemër
gjithë	përemër
dehëse	mbiemër

4.

Mbiemra përcaktorë të paveçuar	Mbiemra përcaktorë të veçuar
Mesjetare	E ndërtuar
Të zhveshur	Të mbështetura
Të përgjumura	

5. 1. E ndërtuar me gurë në një faqe krejt të zhveshur, kështjella mesjetare kishte disa net që po dëgjonte zëra njerëzish.

2. Të mbështetura sup më sup, shtëpitë dukeshin si ca qenie të përgjumura.

17. Ndajshtimi

1. *Drin*; “*Lahuta e Malësisë*”; *trimi i maleve, leka i Malësisë*; *student i vitit të dytë*; *student i vitit të dytë*,
2. *përcaktori*; *i paveçuar, i veçuar*; *i paveçuar*; *emër, grup emëror*; *pushim, presje*.
4. “*Rumia*”; *shkrimtar i shquar*; *Fakulteti Filozofik i Nikshiqit*; *Agronom*; *Profesor*; *Dajë*; “*Traviata*”; *kompozitor me famë botërore*.

18. Kundrinori

1.

Kundrinori i drejtë	Me se është shprehur
I	trajtë e shkurtër
Petro Luarasin	emër
Mihal Gramenon	emër
Çerçiz Topullin	emër
kolonjarë	emër
kupat	emër
e	trajtë e shkurtër
Petron	emër
e	trajtë e shkurtër
babanë	emër
burrin	emër
vëllanë	emër
mësonjësin	emër
mikun	emër
Petron	emër

2. *folja*; *i drejtë, i zhdrejtë*; *objektin (qenien, sendin)*; *kallëzore*; *dhanore*; *parafjalë*;

3.

Kundrinor	i drejtë	i zhdrejtë	i zhdrejtë me parafjalë
rrapin e moçëm	+		
të rinjtë	+		
hasmit		+	
kufirin	+		
me Gencin			+

4.

Kundrinor	i drejtë	i zhdrejtë	i zhdrejtë me parafjalë
të		+	
për djalë			+
i		+	
mëmën	+		
më	+		
më	+		
të birë	+		
çilimitë	+		

19. Përcaktori kallëzuesor

Plotësoni fjalitë.

i kryefjalës; i kundrinorit të drejtë;

foljen kallëzues, kryefjalën, kundrinorin e drejtë; si? Çfarë?;

2.

Kallëzuesorë të kryefjalës	Kallëzuesorë të kundrinorit të drejtë
të një mendjeje	si vajzë të zgjuar
e bukur	mësues
	kryetare
	për trim

3. *Hijet , më të dendura, më të zeza; Treni, i lodhur;
Fëmijët, të mahnitur; Vjeshta, e ftohtë.*

4.

Kallëzuesor i kryefjalës	Shprehet me:
si skelete të bardha	grup emëror
të zhveshura	mbiemër
i çuditshëm	mbiemër
si artiste e vërtetë	grup emëror

5. 1. *Xhaxhi Tomorin e kemi mjekun e familjes.*
 2. *Herë-herë, dielli lëshonte ndonjë rreze midis reve.*
 3. *Këtë erë të ftohtë e të thatë e quajnë mistral.*
 4. *Treni çante me shpejtësi hapësirën e natës.*
 5. *Mjekja e re e paska atë gjuhë mjaltë!*
 6. *Një gjuhëtar i njohur kosovar e ka titulluar studimin e vet “ Kështjellat e sintaksës”.*
 7. *Miroshi e ndiente veten të lehtësuar.*

Kallëzuesorë të kundrinorit	Shprehet me:
mistral	emër
mjaltë	emër
“Kështjellat e sintaksës”	grup emëror
të lehtësuar	mbiemër

20. Përshkrimi

1. *objekt, peizazh, skenë ; e pakryer, e tashme; i mbiemrave*
 2. A. *përshkruan lejlekun, pra, një kafshë*
 B. *një përshkrim*
 C. *në vetën e tretë*
 Ç. *në të tashmen*

D. *shtegtar, të madh, të bardha, të zezë, të gjata, të ndryshme, e parë, verues, i përhapur, Perëndimore, të hapura, të lartë, të bardheme, të vegjël, i përhapur, i rrallë; gjashtëmbëdhjetë mbiemra*

3. A. *në vetën e tretë*
 B. *e pakryer; vetëm në një rast e kryer e thjeshtë*
 C. *bregdetare, i veshur, i vrenjtur, të mbuluara, të ftohtë, e gjallë, flakëruese; shtatë mbiemra*
 Ç. *përshkruan një peizazh*
 D. *përshkrim*
4. *përshkrim i një personi (portret).*

21. Rrethorët

rrethanë; foljen; foljor; hiqen, zhvendosen; vendi, kohe, sasi, shkaku; pas; para

2. *vend, vend, kohë, mënyrë, vend, shkak, qëllim, vend, vend, mënyrë, kohë, vend, qëllim*
3. *Para katër ditësh, në të çarat e mureve, në bedena, brenda kështjellës, Në pusin e tretë, ditë e natë, te gryka e tyre, duke punuar, ditë e natë, kudo nëpër kështjellë, Ditë e natë*
4. *në gjithë krahinën e Katakait, nga malet, si dru, më shumë, më mirë, natën, të nesërmen në mëngjes, në tërë krahinën, atje, më pak*
- 5.

Rrethorët	Kuptimi
në gjithë krahinën e Katakait	vend
nga malet	vend
si dru	mënyrë
më shumë	sasi
më mirë	mënyrë
natën,	kohë
të nesërmen në mëngjes	kohë
në tërë krahinën	vend
më pak	sasi

6. 1. *Për një pe, për një gjilpërë vajti dëm një punë e tërë.*
 2. *Atë ditë ushtarët u ndeshën thikë më thikë me armiqtë.*
 3. *Bujqit biseduan gjerë e gjatë me agronomin.*
 4. *Djali humbi në kurbet si kripa në ujë .*
 5. *Këto janë trojet tona brez pas brezi .*
 6. *Mos i bëj shkel e shko detyrat e shtëpisë.*
 7. *Atë ditë Gjergji punoi sa për katër .*

22. Rrethorori i vendit dhe i kohës

1. *ku kryhet, ku ndodhet, vendi; ku?, në ç'vënd?, nga?, për ku?; kohën, zgjatjen, kohe; kur?, që kur? ë?.*

2.

Rrethantor vendi	Shprehet me:
jashtë.	ndajfolje
vende-vende	shprehje ndajfoljore
tek ti	përemër me parafjalë
në qytetin tim.	grup emëror
rrugëve	emër në dhanore
nëpër rrugët e qytetit	grup emëror

3.

Rrethantor vendi	Shprehet me:
në hotel "Dajti"	grup emëror
në dhomën e tij	grup emëror
në holl	emër me parafjalë
në të njëjtën tavolinë	grup emëror

4.

Rrethantor kohe	Shprehet me:
pa u gdhirë.	formë e pashtjelluar foljore
në orën 5.10.	grup emëror
nesër.	ndajfolje
herë pas here.	shprehje ndajfoljore
para një jave.	emër me parafjalë
para një muaji.	emër me parafjalë
të dielën e kaluar.	grup emëror
muajin e kaluar.	grup emëror
duke dalë.	formë e pashtjelluar foljore

5.

Rrethantorë vendi	Rrethantorë kohe
në shkollë	çdo mëngjes
në të njëjtën skutë	gjithmonë
në faqet e tij të vrazhda	në verë
në shkollë	në dimër
te skuta e ngushtë	
në vesh	

23. Rrethantori i shkakut dhe i qëllimit

1. *pse?, për ç'shkak? për ç'arsye?*

grup emëror, me ndajfoljen pse, përcjellore; përse? për ç'qëllim?, me ç'qëllim?; emër, paskajore.

2.

Rrethantor shkak	Shprehet me:
për një pe,	emër me parafjalë
për një gjilpërë	emër me parafjalë
për një limon	emër me parafjalë
nga një qen	emër me parafjalë
për një plesht	emër me parafjalë
nga dëshira për jetë	grup emëror
nga të lodhurit	emër me parafjalë
përse	ndajfolje

3. Nënvizoni rrethanorët e shkakut.

Rrethanor shkaku	Shprehet me:
nga gëzimi	emër me parafjalë
nga britmat	emër me parafjalë
nga pesha e rëndë e borës	grup emëror
nga lodhja	emër me parafjalë
nga etja e madhe	grup emëror
duke vallëzuar	përcjellore

4. nga frika, nga Skënderbeu

6.

Rrethanor qëllimi	Shprehet me:
për veten tuaj	grup emëror
për botë	emër me parafjalë
për të huaj	emër me parafjalë
për mëmëdhenë	emër me parafjalë
për Shqipërinë	emër me parafjalë

7. 1. qëllim; 2. shkak; 3. qëllim; 4. qëllim; 5. shkak; 6. shkak; 7. qëllim

24. Rrethanori i mënyrës dhe i sasisë

1. si?; ndajfolje, grup emëror, të pashtjelluar;

ndajfolje, grup emëror, të pashtjelluar; masën, shkallën, sasi; sa?;

ndajfolje, grup emëror.

2. mënyrë, mënyrë, sasi, mënyrë, mënyrë, sasi, mënyrë, mënyrë, mënyrë

3.

Rrethanor mënyre	Shprehet me:
si zakonisht	ndajfolje
me shkëlqim	emër me parafjalë
mirë	ndajfolje
duke ngjitur	përcjellore
me ngadalë	ndajfolje
gjithë kujdes	grup emëror
qetësisht	ndajfolje
me zë të lartë	grup emëror

4.

Rrethanor mënyre	Shprehet me:
pa të keq	emër me parafjalë
drejt	ndajfolje
me buzë në gaz	grup emëror
mirë	ndajfolje
shtruar	ndajfolje
shpejt	ndajfolje
shumë lehtë	ndajfolje
me gjithë rrënjë	grup emëror
me një shpejtësi të çuditshme	grup emëror
me bindje	emër me parafjalë
plotësisht	ndajfolje

5.

Rrethanor sasië	Shprehet me:
pesë kilometra	grup emëror
mjaft	ndajfolje
sa e sa herë	shprehje ndajfoljore
disa minuta	grup emëror

6.

Rrethanor sasië	Shprehet me:
dy orë	grup emëror
sa më shumë	shprehje ndajfoljore
pa masë	emër me parafjalë
pesë euro	grup emëror
gjatë	ndajfolje
tre kilogramë	grup emëror

7. 1. me dorë, mënyrë; 2. me mall, mënyrë; 3. shumë, sasi;
4. gjysmë ore, sasi; 5. kolektivisht, mënyrë;
6. në grupe, mënyrë, njëri pas tjetrit, mënyrë; 7. me sukses, mënyrë;
8. pa pushuar, mënyrë, katër kilometra, sasi.
9. afërsi - me afërsi, afërsisht; besnik- me besnikëri, besnikërisht;
bujar- me bujari, bujarisht; burrë – me burrëri, burrërisht;
i egër – me egërsi, egërsisht

25. Letra

1. zyrtare, jozyrtare; shokëve; zyrtare; Shkruan; Drejtohet;
2. jozyrtare; zyrtare

26. Ftesa

- 1: Plotësoni fjalitë.
i drejtohet,; zyrtare, jozyrtare; jozyrtare. zyrtare; kush?, kë?, ku?.
2. A. Drejtori, të ftuarit, promovimi i librit, me 2 janar 2007, në QIK Tuz
B. Ftesë
3. A. zyrtare B. jozyrtare
4. A. jozyrtare B. e paplotë
5. A. zyrtare B. miqësie

27. Justifikimi

1. justifikim
2. kë justifikon
5. A. i dyti; zyrtar i treti
B. jozyrtar, jo, familjare,

28. Rendi i gjymtyrëve të dyta

1. kallëzues, i drejtë; i drejtë
2. i anasjelltë
3. i drejtë, i drejtë
4. A. të drejtë
B. të anasjelltë

29. Shkronja e madhe tek emrat

2. “Vargje për vete”, “Lahuta e Malësisë”, “Dituria”, “14 vjeç dhëndër”,
Leonarda da Vinçit, Van Gogut
5. OKB, SHBA, RSH, ATA, PDS, UDSH

30. Shkrimi i datave

1. pikë, vizë, fjalë, më
2. 18.4.2007; 21-VI-1995
3. A. a; B. a; C. a; Ç. b

CIP - Каталогизација у публикацији
Централна народна библиотека Црне Горе, Цетиње

371.3:811.18(035)

БЕСИ, Бахри

Комуникојмë dhe hartojмë, пërdorim gjuhën : gjuha shqipe
7 : përklasën e shtatë të shkollës fillore nëntëvjeçare : libri i më-
suesit / Bahri Beci ; [ilustrimi Darko Dërleviq]. - Podgoricë :
Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore, 2007 (Podgorica : Studio
Mouse). - 80 str. ; ilustr. ; 30 cm

Tiraž 50.

ISBN 978-86-303-1214-4

а) Албански језик - Настава - Методика - Приручници
COBISS.CG-ID 11962128